



E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2002

Në këtë numër:

Marrëdhëniet deputet zgjedhës:
për një rritje të përfaqësimit
dhe besimit tek institucionet

- Roli përfaqësues
- Aspekte të komunikimit dhe etikës
- Zyrat e deputetëve
- Roli i shoqërisë civile në procesin legjislativ

8

Botimi i Qendres Studimore
Mbi Praktikat Parlamentare
Dhe Demokratike

PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri VIII, viti 2002

	Faqe
Marrëdhëniet deputet-zgjedhës: Për një rritje të përfaqësimit dhe besimit tek institucionet	
Përhëndetje e Dr. Makbule ÇEÇO	4
Fjala Znj. Jozefina TOPALLI	9
Raport për gatitur nga Qendra e Studimeve Parlamentare mbi projektin “Marrëdhëniet deputet zgjedhës”	12
Roli përfaqësues i deputetit: Vështrim analitik në përvojën e krijuar	
Pjetër ARBNORI	24
Haxhi ALIKO	29
Aspekte të komunikimit dhe etikës	
Musa ULQINI	37
Komunikimi me zgjedhësit dhe efektiviteti i veprimtarisë së deputetit	
Ferid HOTI	41
Pjesëmarrja e publikut në procesin legjislativ: Transparenca në veprimtarinë e Kuvendit	
Njazi JAHO	46
Shoqëria civile dhe ligji: një marrëdhënie në zhvillim	
Gent IBRAHIMI	51
Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend	
Filip LAKO	57
Përmbledhja e përkthyer anglisht	
Raport mbi projektin “Marrëdhëniet deputet zgjedhës”	63
Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend	75

TABLE OF CONTENTS

8th Issue, year 2002

	Page
Relations between MPs and electors: For an increase of representation and trust at the institutions	
Greeting from Dr. Makbule ÇEÇO	4
Speech from Mrs. Jozefina TOPALLI	9
Report prepared by the Center on Parliamentary Studies on the project “Relations Members of Parliament-electors”	12
Representative role of the MP	
Pjetër ARBNORI	24
Haxhi ALIKO	29
Aspects of the communication and ethics	
Musa ULQINI	37
Communication with electors and efficiency in the activity of the MP	
Ferid HOTI	41
Public Participation in the legislative process: Transparency in the activity of the parliament	
Njazi JAHO	46
Civil society and the Law: a relation in development	
Gent IBRAHIMI	51
Information on laws passed by the Assembly	
Filip LAKO	57
Summary in English	
Report on the project “Relation between MPs and electors”	
Information on laws passed by the Assembly	75

Kjo rubrikë synon prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike për organizmin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studjuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanëshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Në këtë numër të Revistës është përzgjedhur çështja e përfaqësimit, e shprehur në marrëdhëniet deputet-zgjedhës, duke patur parasysh rëndësinë që ka ky institut për funksionimin e demokracisë përfaqësuese dhe për legjitimitetin e pushtetit ligjvënës. Materialet në vazhdim janë prezantuar në Konferencën mbi “Marrëdhëniet deputet-zgjedhës: për një rritje të përfaqësimit dhe besimit tek institucionet”, mbajtur në Tiranë më 4 mars 2002, me mbështetjen e Institutit Ndërkombëtar Republikan Amerikan.

Marrëdhëniet deputet-zgjedhës: Për një rritje të përfaqësimit dhe besimit tek institucionet

*Fjala përshëndetëse e Dr. Makhbule Çeço
Zv.Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë*

Të nderuar organizatorë,

Të nderuar pjesëmarrës, kolegë deputetë dhe të ftuar,

Zonja dhe Zotërinj,

Kam kënaqësinë, por njëherazi ndjehem e nderuar dhe e obliguar, të falenderoj organizatorët e Konferencës, Qendrën e Studimeve Parlamentare në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar Republikan Amerikan, dhe të përshëndes punimet e kësaj Konference, me një tematikë dhe problematikë tejet të rëndësishme dhe aktuale për procesin e thellimit të demokracisë, përmes përsosjes së marrëdhënieve deputet-zgjedhës: si një ndër faktorët kryesorë për rritjen e përfaqësimit dhe besimit te institucionet, duke ju uruar punë të mbarë e suksese në emrin tim si kolege e shumicës së pjesëmarrësve në këtë veprimtari, si dhe në emër të Kuvendit të Shqipërisë.

Tematika e përzgjedhur e kësaj konference është, sa komplekse e me një diapazon të gjerë, aq dhe e një rëndësie të veçantë, në kushtet kur vendi ynë, shoqëria shqiptare dhe institucionet e shtetit shqiptar janë në rrugën e transformimit të vazhdueshëm të tyre demokratik, të forcimit e konsolidimit, të qëndrueshmërisë e integritetit të tyre, dhe njëherazi, të përsosjes së marrëdhënieve ndërmjet tyre. Problemet e institucioneve dhe reformimit të tyre, që, në thelb, kanë të bëjnë me qeverisjen në tërësi, në të gjitha fushat e

jetës; qendrore, rajonale, vendore, ligjvënëse, gjyqësore, ekonomike, shëndetësore, arsimore, kulturore, sociale, ushtarake, të sigurisë e të rendit etj., brenda kuadrit të një sistemi politik, parë në këndvështrimin e përmirësimit funksional dhe stabilizimit të këtij sistemi përmes institucioneve, trajtimi, analiza, përgjithësimi i tyre janë sa të domosdoshme e të rëndësishme, aq dhe të mprehta për kushtet tona, kur tashmë është fituar një përvojë qeverisjeje në një sistem politik pluralist demokratik 10 vjecar, por që kemi ende shumë për të bërë për të fituar besueshmërinë e qytetarit, të komunitetit, të zgjedhësve.

Kjo problematikë, në vlerësimin tim, nënkupton një proces të tërë reformash të lidhura e të ndërvarura reciprokisht, politike, filozofike, botëkuptimore, psikologjike, legjislativë, juridike, ekonomike, institucionale, menaxhuese të burimeve njerëzore etj., që natyrshëm, kërkojnë një periudhë, e cila tenton të jetë e gjatë, dhe ku gjithçka do të varet nga përgjegjësia politike, në radhë të parë, e institucioneve të shtetit, duke filluar nga parlamenti e deputetët si ligjvënës dhe deri tek shoqëria civile, si partnere, dhe njëherazi, si oponente e hapave që duhet të ndërmerren e hidhen në vazhdimësi.

Tradita parlamentare në vendin tonë ende nuk ka mundur të ofrojë fizionominë e marrëdhënieve të konsoliduara deputet-zgjedhës, ndonëse përpjekje në këtë drejtim janë bërë. Të tilla janë ndryshimet e herëpashërshme në statusin e deputetit, të cilat kanë sjellë përmirësime në krijimin e lehtësive dhe punës së deputetëve me zgjedhësit. Por të gjithë e ndjejnë që këto marrëdhënie deputet-zgjedhës duhen përmirësuar. Në këtë kontekst, gjykoj, që këto marrëdhënie mund të bëhen objekt i analizave, pse jo, dhe i studimeve, me synimin për hartimin e një strategjie në këtë drejtim dhe në përputhje me të dhe orientimin dhe përmirësimin e legjislacionit përkatës.

Gjykoj dhe vlerësoj se edhe kjo Konferencë, zhvillohet në kohën e momentin e përshtatshëm dhe do të japë ndihmesën e vet në ndërmarrjen e hapave që duhen bërë për zvogëlimin e distancës që ekziston, jo rrallë, mes zgjedhësve dhe të zgjedhurve të tyre dhe afrimin e tyre me jetën institucionale nëpërmjet përdorimit të rrugëve ligjore dhe të drejtave të tyre në përballimin

e problemeve të përditshme, duke zhvilluar, rritur, zgjeruar dhe përsosur rrugët e komunikimit të ndërsjellë.

Në këtë kuadër, përsosja e marrëdhënieve deputet-zgjedhës përmes përforcimit e zgjerimit të shkallës së përfaqësimit, mendoj se është një ndër faktorët dhe aspektet kryesore të forcimit e rritjes së besimit të zgjedhësve, të komuniteteve të qytetarëve, të grupimeve e shtresave të ndryshme të qytetarëve, të shoqatave joqeveritare, të komunitetit të biznesit, të faktorëve të tjerë të rëndësishëm jopolitikë, përgjithësisht të shoqërisë civile e të opinionit publik tek institucionet në përgjithësi, duke filluar nga ato qendrore e deri tek ato vendore, nga ato ligjvënëse e deri tek ato publike ekzekutive nga qendra në bazë.

Kjo është njëra anë e problemit. Ana tjetër, po aq e rëndësishme, ka të bëjë me tërheqjen e zgjedhësve në pjesëmarrjen aktive të proceseve të zhvillimit e demokratizimit të vendit, të kultivimit përmes këtyre proceseve të një mendësie, psikologjie e mentaliteti të ri demokratik qeverisës, bashkëveprues e bashkërendues, për emancipimin e gjithanshëm të shoqërisë shqiptare dhe për përshpejtimin e ritmeve për përmylljen e tranzicionit tonë të gjatë e të vështirë, për përballimin e sfidave të procesit të përafrimit të shoqërisë shqiptare në të gjitha fushat, ligjore, ekonomike e sociale me standartet e vendeve e shoqërive demokratike të zhvilluara, që do të kurorëzojë me sukses procesin e integritimit euroatlantik, si një vullnet tërësor i popullit tonë.

Me rëndësi të veçantë në problematikën e gjerë të marrëdhënieve deputet-zgjedhës gjykoj se, përveç të tjerash, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet veprimtarisë së deputetit dhe përsosjes së vazhdueshme të kësaj veprimtarie si deputetë-përfaqësues të trupave zgjedhore të caktuara në drejtim të vendosjes së marrëdhënieve të besimit, bashkëpunimit e bashkëveprimit reciprok, që siguron kontrollueshmërinë për veprimtarinë e tyre në shërbim të shtetasve, zgjedhësve, që, njëherazi janë dhe taksapagues, për probleme të zhvillimit të komunitetit përkatës, me qëllim që zgjedhësit të mos mbeten në mendësinë e vjetëruar se si të tillë, duhen vetëm një herë në katër vjet, për të dhënë votën, dhe me qaq mbaron misioni i tyre.

Në konceptet për një qeverisje moderne, që realizohet nga institucione të reformuara moderne, që për gjykimin tim një prej tyre është dhe institucioni i deputetit, presupozohet marrëdhënia bashkëvepruese, përfshirja e tërheqja e një mase sa më të madhe njerëzish të integruar në problemet e jetesës dhe të bashkëjetesës, në organizimin dhe veprimin e mendimit qytetar dhe të opinionit publik, në shkëmbimin e opinioneve si bazë për dialogim, në reciprocitetin e hapur, si domosdoshmëri për të krijuar bindjen e besueshmërinë për një të vërtetë që i shërben mbarëvajtjes së një komuniteti, të një shoqërie demokratike.

Besoje se kjo problematikë do të rrokët në tërë gamën dhe rëndësinë e saj, në prezantimin e tematikës së rolit përfaqësues të deputetit në dritën e vështrimit analitik të experiencës së krijuar dhe në diskutimet që do të zhvillohen rreth kësaj tematike.

Po të së njëjtës rëndësi në përsosjen e këtyre raporteve e marrëdhënieve të besimit reciprok, do të evidentojta dhe problematikën e gjerë të aspekteve të komunikimit dhe të etikës deputet- zgjedhës e, veçanërisht, problematikën që ka të bëjë me rolin e zyrave të deputetëve në zonat elektorale si një risi pak vjeçare, por që përbën një nga pikat e kontaktit të vazhdueshëm jo vetëm me elektoratin, zgjedhësit, por dhe me qeverisjen vendore, bashkëpunimi, bashkërendimi dhe koordinimi me të cilën do të krijonte hapësira më të gjëra, mundësi konkrete më të mëdha në funksion të zgjidhjes së shqetësimeve të elektoratit, tërheqjes së mendimit e këshillimit, shkëmbimit të informacionit për kërkesat e interesat e shtresave, grupeve dhe tërë komunitetit zgjedhor, për zhvillimin e zonës, për pjesëmarrjen aktive të komuniteteve zgjedhore në proceset zhvilluese e transformuese, për rritjen e transparencës në veprimtarinë e institucioneve publike, vendore e qendrore, deri në procesin legjislativ, për komunikimin e sqarimin e politikave të ndërmara në fushën legjislative, ekzekutive, ekonomike, sociale, përfshi dhe problematikën që lidhet me përmbushjen, zgjidhjen e përmirësimin e kërkesave më elementare të jetës së përditshme, si: uji, dritat, infrastruktura rrugore, rrjetet e kanalizimeve, punësimi, strehimi etj. Në këtë kontekst më duket shumë me interes dhe programimi si

një tematikë më vehte i rolit të shoqërisë civile në procesin e bërjes së politikave dhe zbatimit të legjislacionit. Identifikimi i problemeve që lidhen me përsosjen dhe konsolidimin e marrëdhënieve deputet-zgjedhës, me rritjen e përfaqësimit dhe çështjen e besimit të publikut tek institucionet, si synim kryesor i temave të përcaktuara dhe diskutimet rreth tyre në këtë konferencë, konkretizimi në formën e rekomandimeve dhe publikimi i tyre, do të përbëjnë një ndihmesë me vlerë në ndërmarrjen e masave konkrete dhe iniciativave përkatëse ligjore nga strukturat dhe institucionet shtetërore, sipas kompetencave të tyre, për përmirësimin e mëtejshëm e të vazhdueshëm të këtyre marrëdhënieve, për ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme demokratike, për ndërtimin e shtetit ligjor.

Duke ju uruar edhe një herë suksese dhe punë të mbarë, ju falenderoj për vëmendjen!

Marrëdhëniet deputet-zgjedhës: Për një ritje të përfaqësimit dhe besimit tek institucionet

*Fjala e znj. Jozefina Topalli
Zv.Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë*

Përcaktimi i përgjegjësive të deputetit gjatë viteve ndryshon, po ashtu edhe për të zgjedhurit vendorë. Megjithatë, ato vazhdojnë të përfshijnë përfaqësimin e interesave vendore, shërbimin zgjedhor, mbrojtjen e politikës partiake në nivel kombëtar, veprimtarinë në komisione parlamentare.

Pavarësisht nga e përgjithshmja, çdo deputet ka një axhendë vetjake, përparësi individuale për realizimin e të cilave nevojitet edhe një infrastrukturë mbështetëse, që vërtet ka ndryshuar në vite, por që mbetet jo rrallë e diferencuar nga qenia në pozitë/opozitë dhe që është për arsye të kuptueshme e pamjaftueshme.

Çdo deputet i zgjedhur në zonë, natyrshëm, shërben si avokat ose ambasador për nevojat e zgjedhësve të tij. Për të realizuar këtë, deputeti është i detyruar të udhëtojë shpesh në zonën e tij për takime, mbledhje me individë ose grupe të organizuara, ka detyrë t'u kthejë përgjigje letrave e ankesave për çështje të ndryshme. Është i detyruar të jetë i informuar për çfarë thuhet në televizionet lokale, si dhe të jetë i pranishëm aty.

Nganjëherë roli i deputetit klasifikohet si roli i delegatit, pra, ai pranon të përcjellë çdo gjykim të zgjedhësve të tij. Nganjëherë ai preferon të veprojë sipas iniciativës dhe sipas një gjykimi të tij. Në shumicën e tyre deputetët

zgjedhin rrugën e mesme - pra të jenë pak delegatë, pak kujdestarë, pak ndërmjetës.

Megjithatë, çdo deputet, në fund të fundit, është i ndërgjegjshëm se si rezultat i dallimeve jo të vogla midis prefekturave, vetë Kuvendi duhet t'i përgjigjet problemeve me frymën e interesit e të politikës kombëtare. Si rrjedhim, secili prej nesh i referohet çështjes në atë formë që të përfshijë interesat e çdo zone me interesin e të gjitha zonave, pra të vendit.

Disa nga deputetët mbajnë edhe pozicione drejtuese brenda partive të tyre politike. Ata vërtet janë të mbingarkuar, por duke qenë edhe me më shumë përvojë, e kanë të qartë se nuk mund të qëndrojnë vetëm në zyrë.

Ata e dinë se burra shteti janë vetëm ata që zgjidhen dhe, për t'u zgjedhur, duhet të kesh ura komunikimi shumë të forta me zgjedhësit, çka në Shqipëri përktthehet se duhet të merresh edhe me kanalin e fshatit, edhe me shkollën, edhe me ujesjellësin, edhe me telat e elektrikut, edhe me makinat e zhavorrit, dhe për fat të keq edhe me bursën ose asistencën. Jo rrallë, duhet të bësh vizita për raste gëzimi e hidhërimi dhe për të gjitha këto nevojitet një zyrë, një sekretar, një lidhje, bashkëpunim dhe bashkërendim i përpjekjeve me kryeplakun, kryetarin e komunës, kryetarin e bashkisë, këshilltarët e bashkisë dhe me strukturat e partisë që të kanë zgjedhur. Deputeti duhet të dijë të paraqitet përmes punës së tij legjislative, diskutimeve, raporteve, si modeli i votuesve tuaj.

Të gjithë janë të vetëdijshëm se deputetit këtu në Shqipëri, së pari, i është dashur të japë ndihmesë, që sistemi i ri politik të zërë rrënjë në shoqërinë tonë, shoqëri që për një kohë të gjatë nuk e ka njohur demokracinë e përfaqësimit.

Pastaj, të luash rolin e deputetit, kur papunësia është rritur frikshëm, kur sistemi administrativ ka shumë për t'u rimodeluar, kur sistemi i shpërndarjes së energjisë është në ditën e saj më të zezë, nuk është komforte. Me fjalë të tjera, puna zgjedhore duhet bërë në kushte të pazakonshme, çka vështirëson rregullimin e punës parlamentare në komisione, në seanca, me punë në terren, rregullimin e shpenzimeve të burimeve, kohën dhe strategjinë për të krijuar besimin vetjak dhe për të siguruar përkrahjen e nevojshme për t'u zgjedhur.

E më pas, duhet të kesh guxim të kandidosh për post politik në kohën e ndryshimeve dhe të pasigurisë së madhe (këtu kam parasysh dhe zhvillimet e fundit të betejave mes padronëve e abuzuesve e të korruptuarve), lavatriçe të parave dhe prokurorëve politikë.

Sidoqoftë, për politikanët e rinj, shumë gjëra mbeten për të mësuar. Boshllëqe për ta ndihen sidomos në zonën e ligjit, në procesin parlamentar, në njohjen e sistemit politik. Duke synuar reduktimin e boshllëqeve, ndodh disa herë, që çështje individuale të qytetarëve shpesh të lihen pasdore, në favor të projekteve të mëdha politike. Dhe, në fakt, arena parlamentare realisht nuk është gjë e vogël, përkundrazi, ka nevojë për shumë kohë. Dhe çdo gjë mësohet në procesin e provave e të gabimeve.

Marrëdhëniet deputet-zgjedhës: për një rritje të përfaqësimit dhe besimit te institucionet

*Raport për gatitur nga Qendra e Studimeve
Parlamentare mbi projektin e mbështetur nga
Fondacioni Soros*

Hyrje

Qendra Studimore Mbi Praktikën Parlamentare dhe Demokratike, me mbështetjen e Fondacionit Soros, hartoi projektin “Marrëdhëniet deputet-zgjedhës: për një rritje të përfaqësimit dhe besimit te institucionet”.

Realizimi i këtij projekti synonte identifikimin e problemeve që lidhen me përfaqësimin dhe çështjen e besimit të publikut tek institucionet, si dhe paraqitja e sugjerimeve dhe rekomandimeve për marrjen e masave dhe iniciativave ligjore për përmirësimin e këtyre marrëdhënieve.

Në kuadrin e projektit Qendra kishte këto objektiva:

- Vëzhgimi dhe identifikimi i problemeve që lidhen me marrëdhënien deputet-zgjedhës në drejtim të përfaqësimit.
- Vëzhgimi dhe identifikimi i problemeve që lidhen me marrëdhënien deputet-pushtet vendor.
- Zhvillimi dhe ndërgjegjësimi i opinionit publik për rëndësinë e pjesëmarrjes në jetën politike.
- Zhvillimi i njohurive dhe mundësive të deputetëve në drejtim të kontaktit dhe përfaqësimit të zgjedhësve, duke përfshirë dhe studime krahasuese për eksperiencat e vendeve të tjera.

· Zhvillimi i kuptimit që kanë zgjedhësit për procesin e vendimmarrjes, si dhe i besimit të tyre në institucionin e Kuvendit.

Projekti filloi në Dhjetor 2000 dhe përfundoi në maj 2001. Aktivitetet në kuadrin e projektit janë strukturuar në tri faza.

I. BAZA LIGJORE

Një nga çështjet e rëndësishme në këtë fushë, që është identifikuar përmes këtij projekti, është Statusi i Deputetit, në mënyrë të veçantë në drejtim të përfaqësimit. Nga analiza paraprake që ka bërë grupi i specialistëve në kuadrin e objektivave të projektit, janë evidentuar këto çështje të rëndësishme ligjore:

1.1 Parimi i përfaqësimit

Ky koncept, në radhë të parë, ka një bazë kushtetuese. Kështu, në nenin 2/2 deklarohet se **“Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti”**.

Gjithashtu, në nenin 70 sanksionohet se: **“Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues”**.

1.2 Roli përfaqësues dhe sqarues i deputetit.

Në ligjin nr.8550, datë 18.11.1999 “Për statusin e deputetit”, në nenin 5 deklarohet se **“Deputeti merr takim periodikisht vetë me zgjedhësit ose kur e kërkojnë ata. Ai i përfaqëson ata duke iu marre mendime për projektligje, amendamente, vendime dhe materiale të tjera që shqyrton Kuvendi, si dhe mund të marrë pjesë në zbrëthimin e tyre”**.

Ky nen parashikon dy elemente të rëndësishme në rolin e deputetit: **a) roli përfaqësues; b) dhe ai shpjegues dhe sqarues me zgjedhësit, për vendimet për të ruajtur besimin dhe legjitimitetin.**

1.3 Zyra e deputetit

Ne nenin 18 të këtij ligji parashikohet se **“... pranë çdo zone elektorale,**

organet e qeverisjes vendore hapin zyra të veçanta pune për deputetët. Kryetari i Kuvendit, me pëlqimin e deputetëve, emëron në shërbim të deputetëve në këto zyra një sekretar, si rregull, me arsim të lartë juridik, i cili pajiset me mjetet e nevojshme të punës. Fondet për nevojat e mësipërme përballohen nga Ministria e Pushtetit Vendor”.

1.4 Marrëdhëniet deputet-pushtet vendor

Një aspekt i rëndësishëm janë dhe marrëdhëniet deputet-pushtet vendor. Në nenin 6 parashikohet që **“Deputeti ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe analizat që organizohen nga organet e qeverisjes vendore”**. Organet e përmendura më lart, si dhe prefektura, në fillim të çdo muaji, i venë në dispozicion deputetëve të rrethit (qarkut) pranë zyrave të tyre, kalendarin e mbledhjeve, duke përfshirë ndryshimet e mundshme që mund t'i bëhen atij.

Kjo baze ligjore si dhe nenet përkatëse në ligjin elektoral janë pikat e referencës në kuadrin e vlerësimit të realizimit në praktikë të parashikimeve të përmendura më sipër. Por, projekti, mbas analizës së të gjitha të dhënave, synon në identifikimin e masave dhe rekomandimeve për përmirësime në aspektin ligjor dhe të praktikave përkatëse.

II. VLERËSIME TË PËRGJITHSHME TË ARRITURA NË PËRFUNDIM TË PROJEKTIT

2.1 Rëndësia e rolit përfaqësues të deputetit

Meqenëse “..populli e ushtron sovranitetin e tij përmes deputetëve...” është e natyrshme që aspekti i përfaqësimit ta detyrojë deputetin të jetë “ambasador dhe avokat” i zgjedhësve të tij, i nevojave dhe opinioneve të tyre. Nga këndvështrimi i interesave të dy “palët” kanë nevojë për njëri tjetrin: deputetit i duhen votat e zgjedhësve për t'u shndërruar në përfaqësues të tyre, ndërkohë që, nga ana tjetër, zgjedhësit janë të detyruar të zgjedhin një përfaqësues për të

prezantuar nevojat, idetë, opinionet e tyre. Natyrisht që në këtë përzgjedhje të përfaqësuesit, një vlerë të rëndësishme merr aspekti politik, pra, pozicioni politik që ka deputeti.

E thënë më shkoqur, në përzgjedhjen e deputetit luajnë rol edhe vetitë personale të deputetit, por, në rastin shqiptar, një peshë të konsiderueshme ka forca politike ku bën pjesë deputeti. Ky raport në përzgjedhjen e deputetit ka impaktin e vet edhe në sjelljen e deputetit me zgjedhësit e tij, në kuptimin e përfaqësimit konform kushtetutës dhe statusit të deputetit. Për më tepër, sipas ligjit elektoral shqiptar, ka dy “lloje” deputetësh: të zgjedhur drejtpërdrejtë nga zgjedhësit dhe të zgjedhur nga lista shumemërore. Praktikisht, “detyrimi” që ata ndjejë për të përfaqësuar zgjedhësit perceptohet dhe realizohet në mënyra të ndryshme.

2.2 Deputeti si përfaqësues i zonës dhe i gjithë elektoratit: Raporti i këtyre interesave.

Në kuptimin e ngushtë, deputeti përfaqëson zgjedhësit e zonës së tij, por, në një kuptim më të gjërë, duke iu referuar edhe nenit 70 të Kushtetutës ku sanksionohet se: **“Deputetet perfaqesojne popullin dhe nuk lidhen me asnje mandat detyrues”**, është e natyrshme që deputeti të konceptohet edhe si përfaqësues i të gjithë elektoratit. Në kuptimin praktik deputeti në shumicën e rasteve është dhe duhet të jetë “ambasador dhe avokat” i zgjedhësve të tij, ai ka detyrim dhe ndaj tij nuk mund të vihet asnjë pengesë që të përfaqsojë në kuvend mendimet apo opinionet dhe shqetësimet e të gjithë elektoratit, sa herë që paraqitet rasti apo ai vetë e vlerëson.

Ekzistenca e deputetëve nga zonat njëemërore apo shumemërore duket sikur i ka ndarë zonat e influencës përkatësisht në deputetë të zonës dhe deputetë të të gjithë elektoratit, gjë që nuk është dhe nuk duhet të jetë e vërtetë. Ky kufi nuk ka përse të jetë i prerë me thikë as teorikisht, as praktikisht.

Në vendin tone, në shumicën e rasteve, deputeti është shfaqur si përfaqësues i zonës së tij, ndërkohë që problemet e të gjithë elektoratit janë mbuluar kryesisht

përmes grupeve politike apo në ndonjë rast edhe të grupeve ad hoc të deputetëve.

Në procesin legjislativ deputeti shfaqet më shumë si përfaqësues i të gjithë elektoratit sesa i thjesht zonës së tij. Ky dimension i deputetit është shumë i rëndësishëm dhe mund të përballohet në rast se deputeti është në kontakt permanent me problematikën politike, e cila, duke qënë pjesë e edukimit politik të deputetit, është prezente në median kombëtare, në takimet apo aktivitetet me natyrë politike, ne seancat e pyetjeve apo të interpelancave që zhvillohen në kuvend, etj.

2.3Roli i Deputetit në zgjidhjen e problemeve që ka zona: (3) Orientim drejt zgjidhjes së shqetësimeve individuale apo drejt atyre që prekin një grup më të madh njerëzish.

Kufiri i angazhimit apo zgjidhjes së shqetësimeve individuale apo të grupit nuk është i prerë me thikë. Është e natyrshme që problemet e grupit të kenë prioritet, ndërkohë që problemet individuale në shumicën e rasteve kanë natyrë personale.

Nga eksperiencia e deritanishme rezulton se shumica e problemeve vijnë nga individë dhe kanë natyrë personale: gjetje vëndi pune, gjetje vize, dërgim për vizitë mjekësore jashtë shtetit, zgjidhje problemesh me gjykatën apo administratën publike, gjetje kredie, gjetje bursash për fëmijë jashtë shtetit, etj. Këto probleme lidhen kryesisht me pamundësinë e zgjidhjes së problemeve me shtetin ose për arsye të mosfunksionimit normal të këtyre insiticioneve, ose për shkak të mentalitetit të vjetër të zgjidhjes së halleve me një “mik” nga lart. Zgjidhja e këtyre problemeve kërkon shumë kohë dhe, nga ana tjetër, krijon në shumicën e rasteve nje konceptim dhe opinion të gabuar për punën dhe personalitetin e deputetit. Por, me sa duket, kjo dukuri do të mbetet prezente për një kohë ende të gjatë. Është një mentalitet që gjendet edhe në vende me demokraci më të vjetër.

Angazhimi në zgjidhjen e problemeve të grupit është natyrisht detyrim. Mënyra dhe prioriteti që i duhet dhënë zgjidhjes së tyre është çështje e diskutueshme.

Si konkluzion, mund të thuhet se deputeti merret dhe do të duhet të vazhdojë të merret me shqetësimet e individëve dhe të grupeve, duke përcaktuar prioritetin e angazhimit të tij në funksion të gravitetit të shqetësimit, por duke tentuar të ruajë, në përgjithësi, parimin që shqetësimet e grupit kanë prioritet ndaj atyre individuale.

2.4 Njohja e deputetit me problemet që ka zona dhe rrugët e mundshme për zgjidhjen e tyre

Takimi më zgjedhësit është një detyrim ligjor, në statusin e deputetit siç është thënë edhe më sipër Takimet janë, natyrisht, mjete më i mirë për t'u njohur me problemet që ka zona. Me takime duhet të kuptojmë:

- Takime direkte me grupe zgjedhësisht;
- Takime me të zgjedhurit vendorë;
- Takime me grupe të organizuara në zonë: biznesmenë, sindikata, të rinjtë, gratë, OJQ-të, etj.
- Takimet me forumet e partisë që ai përfaqëson.
- Deputeti mund të njihet me problemet e zonës edhe nga:
- Shqetësimet e ngritura nga shtypi lokal dhe/ose kombëtar;
- Shqetësimet e ngritura nga radiot dhe/ose televizionet lokale e kombëtare.

Një rol të rëndësishëm për grumbullimin dhe sistemimin e problemeve të zonës ka Zyra e Deputetit.

Disa nga rrugët e mundshme për ndjekjen dhe zgjidhjen e problemeve të zonës do të ishin:

- Takime dhe ndjekje në organet e zgjedhura vendore;

- Takime me drejtues të administratës lokale;
- Takime dhe ndjekje e problemeve në dikasteret dhe insitucionet qendrore të administratës publike;
- Ndjekje e problemeve përmes zyrës së Deputetit;
- Asistencë për ngritjen e problemit tek Avokati i Popullit;
- Ngritje e problemeve në Kuvend në seancë pyetjesh dhe interpelancash;
- Ngritje e problemeve në median e shkruar dhe elektronike;
- Ngritje e problemeve tek drejtuesit e grupit parlamentar;
- Formulimi i projekt-ligjit që synon të zgjidhë problemin, etj.

2.5 Tërheqja e opinionit të zgjedhësve për projekt-ligje apo akte të tjera gjatë procesit legjislativ

Në Kuvendin e Shqipërisë iniciativa ligjvënese vjen kryesisht nga ekzekutivi dhe në raste të rralla nga deputetët. Në shumicën e rasteve, kur kjo iniciativë vjen nga deputetët, ideja e ligjit është përpunuar nga zyra e grupit parlamentar apo administrata e forcës politike. Këto tregojnë se edhe tërheqja e opinionit të zgjedhësve për projekt-ligje apo akte të tjera ligjvënese është e dobët.

Disa nga rrugët për tërheqjen e opinionit të zgjedhësve do të ishin:

- Takimet me zgjedhësit;
- Grumbullimi i problematikës përmes organeve vendore;
- Grumbullimi i opinionëve përmes zyrës së deputetit;
- Organizimi i sondazheve të opinionëve;
- Organizimi i tavolinave të rumbullakta përmes OJQ-ve të specializuara.

Në disa raste do të duhet të testohet opinionin, pasi një ligj apo akt tjetër legjislativ është miratuar për të vlerësuar perceptimin nga publiku të efekteve të aktit; vetë ky testim mund të shërbejë si mjet për të grumbulluar opinione për amendimin e ligjeve.

2.6 Instrumentet e komunikimit të deputetit me zgjedhësit.

Deputeti komunikon me zgjedhësit në disa mënyra. Ky komunikim mund të shërbejë:

- për të grumbulluar informacion të shumëllojshëm,
- për të evidentuar problemet dhe shqetësimet e zonës,
- për të marrë opinionet e zgjedhësve për procesin legjislativ;
- për të sqaruar zgjedhësit për kërkesat e tyre, për një qëndrim politik të grupit apo një qëndrim të tijin individual;
- për të sqaruar probleme të ngritura nga media për zonën apo probleme të rëndësishme në rang kombëtar.

Disa nga instrumentet e komunikimit do të ishin:

- Takime direkte, të cilat mund të jenë periodike apo edhe joperiodike, për probleme të veçanta të kërkuara nga zgjedhësit apo edhe të vlerësuara nga vetë deputeti;
- Grumbullim informacioni me tematikë të orientuar përmes zyrës së deputetit;
- Diskutim në Kuvend pas një seance pyetjesh apo interpelance në Kuvend;
- Publikim në mediane të shkruar apo intervistë në mediane elektronike.

2.7 Takimet periodike

Takimet periodike do të ishin takime direkte, jo më pak se dy herë në muaj:

- Takime direkte me zgjedhësit;
- Takime me të zgjedhurit lokalë;
- Takime me forumet e partisë në nivel lokal.

Më një frekuencë më të ulët mund të organizohen takime periodike me:

- Grupe intelektualo-profesionale të zonës;
- Drejtues të ndërmarrjeve të rëndësishme të zonës;
- Biznesmenë të zonës;
- OJQ-të dhe shoqatat rinore të grave, veteranët, pensionistët, sindikatat, etj.

2.8 Transmetimi dhe shpjegimi nga deputeti i qëndrimeve të tij në Kuvend zgjedhësve

- Diskutime në Kuvend;
- Takime me zgjedhësit,
- Takime me të zgjedhurit lokalë
- Shkrime në mediane dhe shkruar dhe intervista në mediane elektronike;
- Letër dërguar zgjedhësve përmes drejtuesit të zyrës së deputetit.

2.9 Roli i zyrës dhe sekretarit të deputetit

Ngritja e zyrës së deputetit për çdo zonë elektorale dhe caktimi i sekretarit të deputetit janë një hap i rëndësishëm në realizimin e kontakteve deputet-zgjedhës, deputet-të zgjedhur vendor, deputet-komunitet biznesi, deputet-OJQ e tjerë. Shumë nga problematika e pushtetit vendor kanalizohet me mjaft lehtësi e shpejtësi përmes zyrës lokale të deputetit.

Zyra e deputetit luan një rol të rëndësishëm në grumbullimin e shqetësimeve individuale, ndjekje e zgjedhjes së problemeve të zgjedhësve në nivel lokal dhe të sqarimeve të zgjedhësve për probleme individuale. Sekretari i zyrës lokale shpesh merr pjesë në mbledhje të organeve të pushtetit vendor, për të mbajtur në korrent deputetin për problematikën e tyre.

Zyra dhe sekretari janë ende të pafuqishëm për të luajur rolin e grumbulluesit të opinioneve apo të sqarimit të zgjedhësve për ligjet apo aktet e tjera legjislative.

III. PËRFUNDIME

3.1 Misionet e vëzhgimit

Janë intervistuar rreth 400 persona në qytetet Shkodër, Elbasan dhe Gjirokastër. Vlerësimi i të dhënave të dala nga ky testim do të jenë objekt i tryezave të rumbullakta dhe një studimi më të hollësishëm, por në vija të përgjithshme mund të konstatohet se:

- Nëse shumica e të intervistuarve e njuh deputetin e saj/tij, një pjesë shumë e vogël dëshmon të ketë patur kontakte me të;

- Të intervistuarit kanë shumë pak dijeni për ekzistencën e zyrës së deputetit dhe pothuaj të gjithë dëshmojnë se nuk kanë qenë ndonjëherë në zyrën e tij;

- Po kështu, një pjesë e konsiderueshme nuk ka dijeni për qëndrimin e deputetit në Kuvend, dhe në rastet kur shprehen se kanë dijeni, i vetmi burim është media, kryesisht televizioni. Nuk njihin kanale të tjera për aktivitetin e deputetit në Kuvend dhe mënyrat e komunikimit të qëndrimeve të tij;

- Kur pyeten për nevojën e konsultimit të deputetit me zgjedhësit, në rastin e aprovimit të projektligjeve, shumë nga të intervistuarit kanë vështirësi të kuptojnë se cilat mund të ishin mekanizmat e këtij konsultimi dhe një pjesë jo e vogël e tyre e sheh pozitivisht këtë nevojë, por pa ndonje ide të qartë se si mund të realizohet;

- Lidhur me aktivitetin e legjislativit dhe aprovimin e ligjeve në Kuvend, mund të thuhet se ka një qëndrim pasiv përballë faktit që legjislacioni i aprovuar në një mënyrë apo një tjetër prek direkt interesat e tyre, pra është një çështje për të cilën duhet të jenë të informuar. Një pjesë jo e vogël e të intervistuarve, që ndjek zhvillimet e Kuvendit, interesohet kryesisht për debatet politike dhe jo veprimtarinë e mirëfilltë të legjislativit;

- Shqetësues është fakti që shumica e të intervistuarve mendon se roli i deputetit në Kuvend nuk është i rëndësishëm për përfaqësimin e interesave të tyre.

3.2 Konkluzione

Të përgjithshme:

- Ka një boshllëk informacioni dhe një mungesë besueshmërie të dukshme nga ana e zgjedhësve përballë të zgjedhurve;
- Mbizotëron tendenca e trajtimit të këtij problemi nga ana e deputetit në mënyrë subjektive dhe personale, duke a parë atë vetëm si çështje të prezencës fizike dhe jo si prezencë e autoritetit, interesit, ndërmjetësimit, ngritjes së zërit të tyre, mbrojtjes së interesave etj;
- Ka një dëshirë të madhe nga ana e deputetëve dhe të zgjedhurve, në përgjithësi, për të diskutuar mbi këtë çështje;
- Ndjehet nga të gjitha shtresat dhe aktorët që morën pjesë në tryezat e rrumbullakëta që mungesa e një tradite të këtyre marrëdhënieve ka bërë që ato të ndërtohen në mënyrë spontane dhe pa një strategji të qartë;
- Mirëprejten botime dhe aktivitete në këtë fushë;
- Deputetët ndjehen të pamundur materialisht për të mbajtur një zyrë funksionale, që i përgjigjet kërkesave të kohës dhe sfidave që përballojnë;
- Deputetët janë, gjithashtu, të ndërgjegjshëm, që një pjesë e madhe e kohës dhe e energjive shkon në trajtimin e çështjeve personale të banorëve të zonave të tyre dhe vlerësojnë si pozitive ndihmën për të ndryshuar këtë raport, në favor të çështjeve që shqetësojnë komunitetin dhe më gjerë;
- Tryezat e rrumbullakëta krijuan një bazë të mirë për organizimin e një konference kombëtare në këtë drejtim.

REKOMANDIME:

- Nxitja e botimeve në fushën e marrëdhënieve ndërmjet të zgjedhurve dhe zgjedhësve;
- Botimi i një dokumenti reference, guide për parlamentarët, për marrëdhëniet publike me elektoratin;

- Hartimi i një programi për trajnimin e sekretarëve të deputetëve, si dhe deputetëve të zgjedhur rishtas në parlament;
- Krijimi i një rrjeti të organizatave që bashkëpunojnë me Kuvendin;
- Përpilimi i paneleve për trajnimin e deputetëve në drejtim të:
 1. Përcaktimit të objektivave
 2. Identifikimit të alternativave strategjike
 3. Vlerësimi, zgjidhja dhe zbatimi e strategjisë
 4. Procesit të kontrollit
 5. Marrëdhëniet publike
 6. Manaxhimi i kohës
 7. Hartimit të një plan-veprimi

Në përfundim, dëshirojmë të falenderojmë në mënyrë të veçantë Fondacionin Soros dhe IRI-n për interesin që treguan dhe mbështetjen financiare për projektin. Në të njëjtën kohë, dëshirojmë të falenderojmë të gjithë bashkëpunëtorët, autoritetet dhe deputetë në Kuvendin e Shqipërisë dhe autoritetet vendore për ndihmën dhe mbështetjen që i dhanë projektit në të gjitha fazat e zhvillimit të tij, pa të cilën, projekti nuk mund të realizohej me sukses. Nuk duam të harrojmë me këtë rast dhe të rinjtë që u angazhuan dhe dhanë një kontribut të çmuar në zhvillimin e misioneve të vëzhgimit dhe tryezave të rrumbullakëta në qytetet Shkodër, Elbasan dhe Gjirokastër.

Roli përfaqësues i deputetit: Vështrim analitik në përvojën e krijuar

Z. Pjetër Arbënor
Deputet

Si deputet kam 11 vjet që kam mbajtur pothuajse të njëjtën zonë ose pjesë të saj dhe kryesisht në pesë zgjedhjet e mia si deputet kam gëzuar përkrahjen e zonës fshatare fushore e pjesërisht malore. Shumica e kandidatëve për deputetë, zgjedhje pas zgjedhjesh, kanë ardhur duke e ndërruar zonën zgjedhore, për faktin e njohur të të ashtuquajturit “konsumim”, që në këto vite “tranzicioni” e ka një bazë reale justifikuese. Mosndryshimi i zonës nga unë nuk dua të them se është arsye krenarie, por përvoja ime është diçka që duhet marrë parasysh, sidomos për deputetët e rinj ose kandidatët e ardhshëm.

Para së gjithash, duhen vënë në dukje **marëdhëniet njerëzore me zgjedhësit**. Njoh gjeografinë e zonës dhe historinë e zonës. Janë gjithsejt 44 fshatra, të ndara në 1 bashki e 3 komuna; Vaudejë, Bushat, Hajmel dhe Mnelë-Vig Bashkia e Vaudejës është një fshat i kthyer në kantier ndërtimi hidrocentralesh e në fund në një qytet amalgamë, të përbërë nga vendas dhe të ardhur nga Mirdita, Puka, Zadrimea dhe punëtorët e vjetër të kantierëve, banorë të ca barakave të ndërtuara me popullit e të mbuluara me eternit. Rrethohet nga fshatra me karakter bujqësor, ku banojnë shumë të përndjekur politikë dhe shumë besimtarë dhe arsimdashës.

Kam marrë titullin Qytetar Nderi i Vaudejës, sepse kam dhënë ndihmesë për shpalljen e vendbanimit Qytet dhe Bashki. Kam ndihmuar për investime për ndërtim të disa pallatesh banimi, për ujësjellësin dhe disa marrëveshje për ndihma ndërtimesh komunale për arsimin, shëndetësinë, ujësjellësin, qendrën e tregut, ndriçimin e qytetit etj. Shpeshherë populli m’i atribuon mua të gjitha ndërtimet e bëra, gjë që nuk është

e vërtetë, janë meritat edhe të kryetarit të bashkisë dhe të shumë këshilltarëve, kurse unë mund të kem thënë një fjalë të mirë ose kam ndihmuar me anën e njohjeve me organizatat ose institucionet bamirëse. Fshatrat Guri i Zi, Juban (që tani janë në një zonë tjetër zgjedhore) Laç, Mjedë, Shelqet, Kaçë, Naraç, Spathar etj. janë si një kolanë që e zbukuron fizikisht dhe shpirtërisht Bashkinë e Vaudejës dhe janë nismëtarët e demokracisë më 1990.

Komuna e Bushatit është më e madhja si numër banorësh dhe sipërfaqeje bujqësore. Pjesa më e madhe përshkohet nga rruga nacionale dhe fshatrat Gjondrekaj, Rranxë, Bushat, Kryebushat, Shkjezë, Plezhë, Stajkë, Ashtë, Kosmaç, Melgush etj., që janë të zhvilluara dhe të lidhura krejt me lëvizjen demokratike.

Komuna e Hajmelit është ndër më të varfërat dhe më të përndjekurat në kohën e diktaturës. Si e izoluar nga rruga nacionale, Hajmeli ishte kthyer në vend internimi. Katundi Pistull, Paçram, Dheu i Lehtë, Nënshat kanë shumë probleme ekonomike.

E fundit është Komuna Mnelë-Vig, më e largëta, më e varfëra dhe shumë e përndjekur politikisht. E vogël në numër, me shumë emigrantë ekonomikë, sidomos në Greqi. Mund të them se gjatë 11 vjetëve kam udhëtuar dhjetëra herë në shumicën e fshatrave, po kurrë nuk mund të krenohem se kam vajtur sa duhet kudo dhe aq sa ka nevojë fshati.

Do të paraqes shkurt disa pika ku duhet theksuar roli përfaqësues i deputetit, mënyrat e komunikimit me zgjedhësit.

Njohja e drejtpërdrejtë me njerëzit është e domosdoshme. Kjo njohje realizohet me anën e vizitave të drejtpërdrejta. Dikur njohja bëhej nëpërmjet mitingjeve ose mbledhjeve masive. Tani kjo periudhë është kapërcyer dhe ka kaluar te vizitat shtëpi më shtëpi. Është gabimi më i madh nëse deputeti pret të hapet fushata zgjedhore për të vajtur në fshat. Po shkove më vonë, atëherë do të dëgjosh nga populli talljen: Erdhi tani për të kërkuar vota! Pjesëmarrja në gëzime, dasma, festa të fshatit etj. është e domosdoshme. Vendgrumbullimi më i madh është kisha ose xhamia, ku është rasti për t'u takuar me njerëzit. Në qoftë se deputeti ka mundësi, shkon për t'u pirë një kafe njerëzve edhe nëpër shtëpi. Në rastet e vdekjeve sigurisht duhet shkuar për ngushëllime dhe për më tepër në raste fatkeqësish natyrore.

Vizita e deputetit në vend ka tepër rëndësi. Më kujtohet që duke shkuar një herë në Shkodër, u ktheva në fushën e përmytur të Zadrimes dhe u futa shtëpi më shtëpi dhe oborr më oborr, duke u dhënë dorën njerëzve të tronditur, duke u ledhatuar kokën fëmijëve të mbytur nga balta. Sigurisht, nuk pata me vete ndihma në ushqime ose batanije, por fytyrat e njerëzve ndriçonin nga mirënjohja për vizitën dhe aty këtu dëgjoheshin vërejtje me zë të lartë për deputetin vendas që nuk ishte kujtuar për të vajtur në zonën e vet në ato ditë të këqija. Kur është rasti, mund të pish edhe një gotë raki e pse jo edhe mund të hash një kafshatë bukë te ndonjë familje e dëgjuar ose që ka emër të mirë në fshat.

E rëndësishme është t'i njohësh emër për emër kryetarët ose sekretarët e pushtetit vendor, kryetarët e Partisë Demokratike ose të partive aleate dhe do të fitoje pikë nëse njeh dhe takon njerëzisht edhe kryetarët e partive rivale, madje edhe kandidatit konkurrent. Më kujtohet pesë vjet më parë, më 1997, në qendër të Bushatit në prag të zgjedhjeve u takova me zotin Xhevat Shima, kandidat kundërshtar nga Partia Socialiste dhe pimë një kafe bashkë në kafenenë qendrore të Komunës. Tridhjetë e gjashtë vjet më parë unë e kisha pasur nxënësin në Teknikumin Bujqësor të Kavajës, ku unë isha profesor letërsie. Populli që na shikonte krijoi përshtypje të mirë për ne, aq më tepër që rebelimi i vitit 1997 kaloi pa vrasje, pa djegie e pa grabitje në zonën tonë zgjedhore. Ka tepër rëndësi njohja e meritave të cilitdo dhe respektimi i familjeve me emër të mirë.

Sikurse të presin, duhet të dish edhe t'i presësh njerëzit. Nuk them që duhet t'i presësh për drekë të gjithë banorët e zonës që vijnë në kryeqytet, për shumë punë që ata mund të kenë, por është mirë t'i takosh, të pish një kafe me ta, t'i dëgjosh me durim për hallet që kanë dhe të ndihmosh, kur të mundesh. Janë me dhjetëra rastet që i kam përcjellë te mjeku ose i kam takuar në spital. Fati më ka ndihmuar të njoh mjekë të shquar dhe të ndërhyj pranë tyre për t'u lehtësuar gjendjen të sëmurëve, edhe për t'i shëruar. Këtë ndërhyrje fshatarët nuk ta harrojnë kurrë. Me dhjetëra janë rastet kur kryetarin e bashkisë së Vaudejës ose kryetarin e komunës së Bushatit ose Mnelë-Vigut i kam çuar pranë Ministrave të Bujqësisë, të Pushtetit Vendor, të Arsimit ose nëpër drejtori dhe institucione të ndryshme, për të zgjidhur probleme të ndryshme

të buxhetit, të investimeve, të shkollave, të kanaleve, të ndihmave shoqërore, ose pranë KQZ-së, pranë gjykatave ose Ministrisë së Rendit. Sigurisht, kryetari i komunës ose i bashkisë e kanë më lehtë të çajnë rrugën përkrah deputetit të zonës, i cili, për më tepër, ka qenë Kryetari i Kuvendit dhe i ecën disi fjala. Por jo të gjitha problemet mund të zgjidhen menjëherë, por pushtetari vendor kthehet më i lehtësuar në fshat, kur ka pasur rekomandimin e deputetit të zonës.

Diçka tjetër që ka rëndësi është fjala e mirë, “shpresa”. Fshatarin nuk duhet ta gënjesh kurrë, nuk duhet të të dalë zëri për batakçi. Goja e ëmbël i jep zemër cilindo, sidomos në këtë kohë kur nuk mund të zgjidhësh probleme. Shpesh deputetit i takon edhe të bërtasë, të protestojë, të rropatet, të ballafaqojë, të kërcënojë deri sa ta nxjerrë transformatorin e ri dhe të gëzohet bashkë me fshatarët kur arrin të ndizen dritat përsëri ose të inaugurojë ato 4-5 kilometra rrugë të re. Ka rëndësi njohja e gjendjes ekonomike, papunësia, informacioni për emigracionin, njohja me mësuesit e shkollave, hallet e kanalizimeve, infermierive etj., etj. Sigurisht ka tepër rëndësi njohja e famullitarëve të fshatit, e hoxhallarëve. Të ndihmon tepër nëse për festat e mëdha i shkon për vizitë arqipeshkvit të krahinës ose myftisë së Shkodrës për Bajram.

Ka kandidatë për deputetë që nga dëshira për të dalë të zgjedhur, bëjnë premtime që arrijnë deri në qiell. Katundari është i zgjuar dhe të detyron që t'i premtosh pafundësisht dhe kur kandidati është aq naiv saqë premtom pakufi; fshatari pastaj kthehet dhe e tall.

Unë kam ndjekur një rrugë tjetër: Në pesë zgjedhjet e mija si deputet, që në turin e parë, unë nuk i kam lypur votat askujt. Shprehimisht nuk i kam premtuar askujt asgjë. Po u kam thënë se, në qoftë se zgjidhem dhe nëse partia ime fiton shumicën, kam për të bërë më tepër se ua merr mendja dhe për këtë kam pasur prova konkrete për gjërat që kam realizuar: për kthimin e fshatit në qytet, për emërtimin e Vaudejës bashki, për dy a tri pallatet e banimit, për rrugën e re Vaudejë-Mnelë, për ujësjellësin, për programin 1,200,000 dollarë për farërat dhe teknikën, për kanalizimet etj., etj.

Unë kam dosje të veçanta për ekonomitë bujqësore, për kanalizimet, ujësjellësat, shkollat, problemet e pronësisë së tokës, për gjyqet e konfliktet mes fshatarëve, për besimet fetare (shumica janë katolike, një pakicë janë muhamedanë, por që shkojnë

shumë mirë me njëri-tjetrin), dosje për të përndjekurit politikë etj. Zgjedhësit më kanë porositur që pa zgjidhur problemin e shkeljeve të ligjit në zgjedhje, të mos marr pjesë në Kuvend dhe unë e kam zbatuar.

Kryesorja është që kudo ku ka grumbullim njerëzish, ti si deputet duhet të jesh i pranishëm dhe të shtrëngosh duart e tyre me sinqeritet. Kur nuk mundesh, dërgo një përshëndetje, urim ose ngushëllim sipas rastit. Merr pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak, të këshillit të komunës. Kurrë mos i pengo njerëzit për të folur. Dëgjo, dëgjo, dëgjo, kurrë mos u impono, mos ji i padurueshëm, kurrë mos shit mendje, nga cilido mund të mësosh diçka. Kur nuk je i sigurt, mos fol ose absteno. Ruhu të mos gabosh, të mos bëhesh qesharak. Mëso të bësh urimet sipas zakonit të vendit, të bësh ngushëllimet. Respekto më pleqtë; mos ia pre fjalën tjetrit pa njerëzi. Vishu në rregull, por mos u pispillo tepër se të venë teneqenë. Kur është rasti, pluhuri, balta, shiu, djersa të nderon.

Në raste të veçanta përgjigju letrave me shkrim. Më ka ndodhur në dhjetëra e qindra raste të kem takuar fshatarë të shumtë që kanë nxjerrë një portofol të vjetër dhe më kanë treguar një letër të zhubravitur, duke u krenuar që kishin marrë përgjigje prej meje si Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për hallet a kërkesat e tyre, duke më falënderuar. Sigurisht, unë nuk kam mundur t'ua kthej pronat të gjithëve, as t'ua gjej strehim, as bursë, as pasaportë. Por njerzillëku në përgjigje u kishte lënë përshtypje të mirë që nuk u hiqej nga kujtesa.

Deputeti duhet ta shfrytëzojë televizionin, radion, gazetatat, inaugurimet. Sa herë shkoj në zone, unë kthehem në Shkodër dhe jap një intervistë të gjatë ose të shkurtër për problemet e qytetit tim, për problemet e zonës sime. Gjithashtu, duhet që deputeti i zonës të flasë në Kuvend. Shprehu për problemet. Nuk të kanë zgjedhur për hu gardhi, jep mendimin tënd me masë, se zgjedhësi të dëgjon në mbrëmje. Nganjëherë duhet ta fusësh dorën në xhep se nderon veten tënde. Sigurisht, mos të të shkojë mendja se mund të blesh votat. Në rast se ti mund të shpenzosh pesëqind mijë lekë nga paratë e tua, mos harro që ka bataçinjtë që shpenzojnë 5 milionë, 15 milionë lekë. Megjithatë, nuk blihet vota e gjithë popullit. Po e pate fjalën të ëmbël dhe të drejtë, je më i pasuri i botës dhe do të zgjidhesh më lehtë se i pasuri.

Roli përfaqësues i deputetit: Vështrim analitik në përvojën e krijuar

*Prof. Haxhi Aliko
Ish-Deputet*

Pas vitit 1991 fjala “deputet” nisi të përmendej shpesh në të gjitha mjediset politike, shoqërore, familjare dhe veçanërisht në mediat. Kjo ndodhi jo sepse fjala “deputet” nuk njihej më parë, por sepse me vendosjen e demokracisë ajo mori kuptime të tjera, krejt të ndryshme dhe disi të panjohura më parë. Në dallim nga deputetët e Kuvendit Popullor të periudhës së diktaturës, deputetët e parlamentit demokratik të zgjedhur në mars të vitit 1991, si dhe në zgjedhjet e tjera politike të zhvilluara më pas, patën veçori dhetribute krejt të tjera. Deputeti, nga një figurë që plotësonte në mënyrë pasive dhe të papërcaktuar formacionin politik të shtetit të diktaturës, në demokraci ai u bë protagonist i jetës politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit. Tashmë ai për herë të parë ishte vërtet përfaqësues i popullit në organin legjislativ të shtetit. Në sistemet demokratike, si ai që ka zgjedhur të adaptojë Shqipëria, populli e ushtron pushtetin dhe vullnetin e tij në mënyrë të tërthortë, përmes përfaqësuesve të tij në pushtetin legjislativ, domethënë përmes deputetëve. Duke pasur parasysh atributet kushtetuese dhe funksionet e Parlamentit, atëherë mund të thuhet se populli e ushtron pushtetin e tij në të gjitha hallkat e shtetit, gjithnjë përmes deputetëve të zgjedhur prej tij. E gjitha kjo bën që deputeti, si përfaqësues i popullit, të jetë element themelor në demokraci dhe veprimtaria e tij për përmbushjen e misionit që ka, të jetë garanci për funksionimin normal të demokracisë. Statusi i deputetit dhe integriteti i tij si përfaqësues i popullit në Kuvend, garantohet nga Kushtetuta dhe nga ligji përkatës. Në të dy këto akte ligjore, sidomos në ligjin “Për statusin e deputetit” nuk arrin të jepet në mënyrë të plotë, ashtu siç prezantohet

realisht në mjedisin shqiptar, roli përfaqësues i deputetit. Sipas përcaktimeve, në të dy aktet ligjore, deputeti është përfaqësues i popullit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, përmes të cilit zgjedhjet e një zone të caktuar realizojnë vullnetin e tyre në organin ligjvënës. Por deputeti, realisht, edhe pse nuk përcaktohet në Kushtetutë ose në ligjin përkatës, është edhe përfaqësues i forcës politike që e ka kandiduar dhe, si i tillë, është i detyruar, gjithashtu, ta përfaqësojë atë forcë në Kuvend, të mbrojë programin politik të saj dhe të luftojë që ky program të jetë i pranishëm në sa më shumë vendimmarrje të tij. Është pikërisht ky status i dyfishtë përfaqësimi, që e vë deputetin në pozitën tepër të vështirë, për të vendosur një raport sa më të drejtë dhe të justifikueshëm midis tyre, detyrë e cila jo gjithmonë arrihet të realizohet me sukses dhe që jo rrallë ka pasur pasoja dramatike në veprimtarinë 10-vjeçare të parlamentit demokratik shqiptar. Mbivlerësimi që i bënë deputetët detyrimeve partiake gjatë përbalimit të krizës së krijuar nga shembja e firmave piramidale në periudhën 1996-1997 u shoqërua me humbjen e një pjese të konsiderueshme të besimit të zgjedhësve, duke vetësakrifikuar seriozisht karrierën politike të tyre. E njëjta gjë ndodhi tani së fundi, kur një pjesë e deputetëve të pozitës u angazhuan në mënyrë të tepruar në mbrojtje të interesave politike partiake, duke krijuar situata të mosqeverisjes efektive për një periudhe disamujore, çka kurrsesi nuk ishte në të mirë të interesave të zgjedhësve.

Por në mënyrë të natyrshme deputeti përfaqëson edhe veten e tij në Kuvend, ndërgjegjen e tij, edukatën, moralin, karakterin, nivelin arsimor dhe kulturor të tij, aftësitë individuale dhe kompetencën profesionale, si edhe tipare të tjera që e bëjnë atë të përfaqësojë vlerat më të larta dhe më të çmueshme njerëzore ose të kundërtat e tyre. Me fjalë të tjera, tërësia e vlerave vetjake përcakton nëse deputeti i përket elitës së kombit apo nuk e ka të drejtën të përfaqësojë atë në Kuvend. Kjo e ngarkon deputetin edhe me një detyrim tjetër, që atij i duhet të përfaqësojë denjësisht edhe Kuvendin, si institucionin kryesor të demokracisë, si brenda vendit, ashtu edhe në veprimtaritë ndërkombëtare. Ky rol i tretë përfaqësimi e vështirëson edhe më shumë pozitën e deputetit në vendosjen e raporteve sa më korrekte midis detyrave përfaqësuese që ai ka.

Në aktet ligjore që përcaktojnë statusin e deputetit, nuk ka asnjë referim për gati 1/3 e deputetëve të Kuvendit, të cilët sipas Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor nuk zgjidhen drejtpërdrejt, por nga listat partiake, sipas komponentit proporcional të Kodit Zgjedhor. Nuk ka asnjë dyshim se 40 deputetët e Kuvendit, të ashtuquaturit “deputetët e listave”, janë të zgjedhur nga votat që zgjedhësit u japin partive të preferuara dhe, në këtë kuptim, ata janë përfaqësues realë të popullit. Por zgjedhësit e tyre janë anonimë, ata nuk përfaqësojnë një bashkësi me vendbanim të përcaktuar, po janë të shpërndarë në të gjitha zonat e vendit. Në kushte të tilla, këta deputetë realisht përfaqësojnë vetëm partitë e tyre, veten dhe Kuvendin, megjithëse në Kuvend i ka sjellë vota e popullit. Personalisht nuk jam në gjendje të ofroj ndonjë zgjidhje të pranueshme, për t'i angazhuar këta deputetë si përfaqësues realë dhe efektivë të popullit, po mendoj se gjetja e saj do të ishte një ndihmesë me vlerë në rritjen e rolit të Kuvendit.

Përcaktimi se deputeti përfaqëson popullin në Kuvend është tepër përgjithësues, prandaj do të dëshiroja të bëja një përpjekje për ta konkretizuar atë, duke u mbështetur në përvojën vetjake.

Para së gjithash deputeti duhet të përfaqësojë vullnetin politik të zgjedhësve të tij, të cilët janë edhe shumica e zgjedhësve në zonën ku ai ka kandiduar. Ky detyrim buron thjesht nga fakti se ai është votuar për pozicionin politik të tij, të cilin e ka paraqitur në fushatën zgjedhore, pozicion të cilin e kanë adaptuar ose e kanë gjetur të përbashkët me të shumica e zgjedhësve. Së këndejmi buron edhe detyrimi moral i deputetit, për të mos e ndryshuar statusin politik gjatë legjislaturës për arsye ose interesa individuale. Ndryshimi i përkatësisë politike të disa deputetëve në legjislaturat e kaluara, pavarësisht nga motivimet, përbën një cënim të rolit përfaqësues të tyre.

Përfaqësim i popullit, para së gjithash, do të thotë përfaqësim i interesave të gjithanshme të tij nga ana e deputetit në Kuvend. Kur flitet për interesa, në radhë të parë respektohen ato që janë të përbashkëta për bashkësinë, dhe brenda tij interesat e shumicës, pikërisht të asaj pjese të bashkësisë që ka votuar në favor të deputetit. Kjo nuk do të thotë aspak që deputeti është i çliruar nga përgjegjësia për të përfaqësuar edhe pakicën që nuk ka votuar për të, por respektimi me përparësi i shumicës buron

nga vetë thelbi i demokracisë, ku shumica gëzon të drejtën e përparësisë. Por edhe përfaqësimi i interesave të zgjedhësve individualë përbën detyrim për deputetin, veçanërisht kur ato kanë të bëjnë me cënimin e të drejtave të njeriut. Për të gjitha këto role, deputeti i ka mundësitë ligjore dhe praktike për t'i përmbushur me sukses. Por personalisht jam i prirur të besoj se suksesi do të varet nga aftësia që ka deputeti për të renditur përparësitë në veprimtarinë e tij, duke konsideruar si përparësore realizimin e kërkesave që i interesojnë gjithë bashkësisë, dhe që u shërbejnë shumicës së banorëve të zonës zgjedhore. Angazhimi serioz në ndërmarrje të tilla bën që zgjedhësit të rritin besimin te deputeti i tyre dhe të pakësojnë kërkesat për probleme personale. Përvoja vetjake më ka krijuar mundësitë për ta verifikuar disa herë këtë të vërtetë.

Përmbushja e të gjitha detyrimeve që kanë deputetët e që rrjedhin nga të qenët përfaqësues të popullit, ka qenë dhe vazhdon të mbetet një proces në evolucion të vazhdueshëm, në të cilin ndikojnë mjaft faktore. Disa prej tyre ndihmojnë në konceptimin më të drejtë të detyrës përfaqësuese, por nuk janë të paktë ata që kanë ushtruar ose ndikojnë për deformimin e rolit të deputetit.

Deputetët e zgjedhur në vitin 1992 erdhën në Kuvend pa pasur asnjë përvojë të veprimtarisë parlamentare. Secili prej tyre u përpoq ta konceptojë vetë statusin dhe rolin e tij. Ligji përkatës që u adaptua nuk ofronte shumë dhe për pasojë lindën dhe morën zhvillim disa mënyra të punës së deputetëve si përfaqësues të popullit. Një pjesë e tyre, me ndërgjegje ose padashje, morën përsipër të përballojnë të gjitha kërkesat e zgjedhësve të tyre si bashkësi, por edhe si individë, duke e konsideruar veten dhe rolin e tyre si vendimtar. Në lindjen dhe evoluimin e këtij konceptimi të gabuar ka ndikuar ndjeshëm edhe qëndrimi i administratës shtetërore qendrore dhe vendore. Tranzicioni u shoqërua detyrimisht edhe me reforma të thella administrative, çka solli natyrshëm ndryshime si në strukturën, ashtu edhe në funksionet e saj, por që një pjesë e tyre nuk u realizuan në drejtimin më të mirë. Zëvendësimet e tepruara të nëpunësve mbi kritere politike dhe jo profesionale u shoqëruan edhe me koncepte dhe praktika të gabuara, siç ishte p.sh. shkeputja tërësisht nga drejtimi dhe zgjidhja e problemeve të shumta me të cilat përballoheshin shtetasit gjatë periudhës së vështirë të tranzicionit. Veprime të tilla bënë që administrata shtetërore të largohej

së tepërmi nga hallet e njerëzve, si bashkësi ose si individ, dhe t'i krijonte vetes një bashkësi të pajustificuar, larg përgjegjësive që ajo duhej të mbante. Madje, ajo gjeti edhe një mënyrë tepër origjinale për ta arritur këtë, duke i adresuar të gjitha kërkesat e shtetasve të deputetët që e përfaqësonin. Kjo zhvendosje e përgjegjësive u favorizua mjaft edhe nga mendësia që ekzistonte tashmë të shtetasit e që ishte krijuar gjatë regjimit totalitar, që për çdo problem duhet të drejtoheshin patjetër të një përfaqësues i fuqishëm i pushtetit, i cili në demokraci u konsiderua se qe deputeti, si i vetmi person zyrtar që kishte detyrimin dhe mundësitë për të realizuar dhe zgjidhur gjithçka.

Por ky pretendim i ekzagjeruar u zbeh shpejt, sepse deputeti realisht nuk kishte dhe as që mund të mendohej të kishte ndonjë atribut të pushtetit ekzekutiv. Ai vetëm mund të kërkonte ndaj organeve të pushtetit qendror ose vendor zgjidhjen e problemeve të zgjedhësve, të cilën ia garantonte statusi i tij, por rrallë kjo kërkesë ishte e mjaftueshme për të arritur një rezultat pozitiv. Suksesi u buzëqeshte kryesisht vetëm deputetëve që ishin në të njëjtën kohë edhe qeveritarë, titullarë partiakë ose persona të afërm me ta, ndërsa të tjerët vështirë se mund të ndiheshin të kënaqur nga rezultatet e përpjekjeve të tyre.

Edhe më vështirë ndiheshin deputetët e opozitës, të cilët ishin marginalizuar si rezultat i politizimit të tepruar të jetës në përgjithësi, por veçanërisht të veprimtarisë parlamentare. Atyre nuk u krijoheshin mundësi reale për të përmbushur kërkesat e tyre për zgjidhjen e problemeve të zgjedhësve që përfaqësonin. Në shumicën e rasteve organet e pushtetit ekzekutiv qendror dhe vendor ishin refraktare ndaj kërkesave të deputetëve të opozitës.

Shfrytëzimi i pushtetit ekzekutiv ose politik në favor të disa deputetëve gradualisht u ekzagjerua së tepërmi, çka solli si pasojë deformimin e rolit të deputetit si përfaqësues i popullit. Një ndihmesë të madhe në këtë deformim dhanë edhe mediat, kryesisht ato zyrtare dhe partiake, të cilat e mbivlerësuan së tepërmi rolin e disa deputetëve të privilegjuar, duke i prezantuar ata si të vetmit përfaqësues të denjë të popullit. Në të njëjtën kohë, kjo provokoi “diskreditimin” e pjesës tjetër të deputetëve, të cilët, duke qenë në shumicë, patjetër kompromentuan edhe rolin e deputetit si përfaqësues i popullit, zbehjen e besimit të tij ndaj Kuvendit, ndaj politikës dhe, pse jo, edhe ndaj

demokracisë. Për fat të keq këto shtrembërime dhe keqpërdorimi i pushtetit ekzekutiv dhe politik në rrjedhën e viteve të tranzicionit, nuk erdhën duke u pakësuar dhe përmirësuar me ritmet dhe shkallën që kërkohej; realisht ato janë të pranishme edhe sot. Gjatë 10 vjetëve të tranzicionit ndodhi prishja graduale e ekuilibrit midis pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv, duke e zhvendosur atë në favor të të dytit. Të gjithë e kanë vënë re fare qartë lehtësinë me të cilën realizojnë investime në infrastrukturën e zonave zgjedhore, ku janë zgjedhur ose pretendojnë të zgjidhen, deputetët që kanë edhe poste qeveritare ose partiake, ndërkohë që qeveria është pothuajse e pandjeshme ndaj kërkesave të deputetëve të tjerë. Ministrat pranojnë me gatishmëri të admirueshme vërejtjet dhe kërkesat e deputetëve gjatë seancave të pyetjeve në Kuvend, por mosrealizimi i tyre është pothuajse i përhershëm.

Në marrëdhëniet e deputetit me zgjedhësit, një efekt të ndjeshëm jo për mirë ka pasur edhe përkatësia partiake dhe ndikimi i fuqishëm politik që ushtron ajo mbi deputetin. S'ka dyshim, dhe është plotësisht e përligjur, se çdo deputet duhet të përpiqet për të bërë të mundur materializimin e programit të partisë së tij në veprimtarinë e Kuvendit. Por është krejtësisht e papërligjur që ai të sakrifikojë për arsye politike dhe partiake interesat e zgjedhësve të tij. Historia 10-vjeçare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është shumë e pasur me shembuj që tregojnë se në raportin midis përfaqësimit të partisë dhe përfaqësimit të popullit, shumë deputetë kanë mbivlerësuar të parën, duke humbur kështu një pjesë të konsiderueshme të besimit të zgjedhësve.

Por ndikimi jo për mirë i politizimit të tepruar partiak mbi marrëdhëniet e deputetit me zgjedhësit manifestohet dukshëm sidomos në fushatat zgjedhore. Programet zgjedhore partiake jo rrallë, me premtime të tepruara e të pambështetura, të cilat mandej amplifikohen dhe ekzagjerohen deri në absurd nga kandidatët për deputetë, sjellin pasoja dramatike. Në rast se kandidatë të tillë fitojnë, atëherë ata, krahas fitores duhet të festojnë edhe diskretitimin e tyre përpara zgjedhësve, sepse shumë shpejt do të jenë mosmbajtës të premtimeve dhe mashtrues, tipare të mjaftueshme për të humbur çdo simpati dhe besim të zgjedhësit.

Jo më pak i cënon marrëdhëniet deputet - zgjedhës edhe presioni që i bën partia deputetit, për të ndërhyrë në punësimin ose emërimin në poste administrative të lakmuara të militantëve ose individëve pranë tyre, të cilat, si rregull, rrallë janë të goditura profesionalisht dhe të justifikuara ligjërisht dhe moralisht. Gjatë 10 viteve të tranzicionit kjo ka qenë një dukuri e shpeshtë dhe që fatkeqësisht përsëritet në mënyrë ciklike në çdo legjislaturë, veçanërisht tepër e shprehur në administratën e pushtetit vendor, ku ndikimi i deputetit është më i dukshëm. Ndërhyrje për veprime të tilla pasohen jo vetëm nga humbje totale e besimit të zgjedhësve, që nuk i përkasin partisë së deputetit dhe që nuk kanë votuar për të, por edhe nga lëkundja e besimit të zgjedhësve që kanë votuar për të. Miratimi i ligjit “Për statusin e nëpunësit civil” nga Kuvendi i mëparshëm do të jetë një mjet mjaft i fuqishëm për të ndaluar përqësimin e mëtejshëm të kësaj dukurie.

Por faktori që ka ndikim më të fuqishëm në përcaktimin e marrëdhënieve deputet-zgjedhës është vetë deputeti. Deputetët që zotërojnë tiparet më të mira të karakterit, moralit, aftësive, nivelit intelektual dhe kulturor, kompetencës profesionale, si dhe veçori të tjera pozitive, padyshim që nxisin te zgjedhësit forcimin e besimit dhe të respektit për përfaqësuesin e tyre në Kuvend. Vetëm figura të tilla të kompletuara mund të krijojnë mirëkuptimin e ndërsjellë deputet - zgjedhës. Çdo mangësi në figurën dhe personalitetin e deputetit, çfarëdo sjellje ose qëndrim jokorrekt i tij, çdo shmangie nga përgjegjësia dhe detyrimet që rrjedhin prej mandatit që zotërojnë, që të gjitha pasqyrohen në shkallë të ndryshme në cenimin dhe keqësimin e marrëdhënieve të tij me zgjedhësit.

Mungesa e një kodi etik dhe moral për deputetin, sikurse në shumë parlamente të botës, ka bërë që deputetët shqiptarë, për shkak të mosdijes, keqkuptimit të të drejtave të tyre ose rënies viktimë e intrigave të ndryshme, të shfaqin qëndrime dhe veprime të papëlqyeshme, madje edhe joligjore, të cilat kanë pasur rrjedhoja serioze për dëmtimin e figurës së tyre. Në mediat e shkruara ose vizive gjen të pasqyruara mjaft raste të tilla, të cilat së bashku me opinionin e gjerë publik, të krijuar pjesërisht edhe prej tyre, kanë ndikuar fuqishëm në zbehjen graduale të figurës së deputetit si përfaqësues i popullit.

Është vërtet dëshpëruese kur vëren se në anketat e organizuara në kohë të ndryshme rezulton një përqindje e lartë e të anketuarve që nuk kanë besim te politikanët, ku përfshihen edhe deputetët. Fatekeqësisht ky opinion ka ardhur vazhdimisht duke u forcuar, duke dëmtuar seriozisht besimin dhe shpresën për të ardhmen e demokracisë, por në mënyrë të veçantë kanë ulur ndjeshëm respektin dhe besimin për parlamentin.

Parlamenti është ura institucionale që lidh shtetin me shoqërinë, me popullin, dhe duke qënë bastioni i vetëm kundër kaosit, arbitraritetit dhe diktaturës, atëherë çdo dukuri që cenon besimin ndaj tij, përbën rrezik serioz për vetë demokracinë. Që parlamenti të përmbushë me sukses këto funksione jetike, para së gjithash, është e domosdoshme që deputetët të jenë në ballë të përpjekjeve për të ruajtur autoritetin dhe dinjitetin e parlamentit. Në rast se deputetët nuk janë një shembull për shtetasit e tyre, me sjelljet dhe përpjekjet për të ndërtuar një shoqëri të ndershme dhe të drejtë, atëherë publiku i gjerë do të humbasë besimin jo vetëm tek ata, por edhe tek institucionet publike, qeverinë dhe vetë demokracinë.

Si mund të pretendojnë politikanët (këtu edhe deputetët) në fjalimet e tyre, që shtetasit e thjeshtë duhet të jenë të ndershëm dhe të respektojnë ligjet, në rast se ata ndjejnë dhe binden që i zgjedhuri i tyre, ai të cilit ata i besuan kur votuan për të, nuk është model i virtytit? Nuk ka simbol integral më të përshtatshëm për demokracinë se sa figura e kompletuar e deputetit dhe, për rrjedhojë, kur deputeti dështon në misionin e tij, atëherë zgjedhësit do të humbasin edhe besimin te vetë demokracia.

Në përfundim të kësaj ligjërate natyrshëm lind pyetja: A ka evoluar për mirë dhe me ritme të kënaqshme procesi i formimit të deputetit si përfaqësues i denjë dhe i merituar i zgjedhësve? A po i kryen ai të gjitha detyrimet që burojnë nga mandati që zotëron në mënyrë të drejtë dhe në nivelin e duhur? E kam tepër të vështirë dhe pothuajse të pamundur për çastin që të jap një përgjigje të qartë dhe të saktë për këto pyetje, por ajo që mund të them me bindje është se deputeti shqiptar ka ende shumë rrugë për të bërë, për të arritur atë simbol të demokracisë që do të dëshironim të gjithë që të ishte.

Marrëdhëniet deputet zgjedhës: Aspekte të komunikimit dhe etikës

Z. Musa Ulqini
Deputet

Në Shqipëri, me vendosjen e pluralizmit dhe organizimin e zgjedhjeve të lira e demokratike, filloi të funksionojë marrëdhënia e re deputet-zgjedhës në jetën publike të vendit.

Tashmë është krijuar një përvojë e funksionimit të marrëdhënieve deputet-zgjedhës dhe është krijuar edhe kuadri ligjor i nevojshëm. Me funksionimin e zyrës së deputetit në çdo zonë zgjedhore, po krijohet edhe infrastruktura e nevojshme.

I KUADRI LIGJOR.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është sanksionuar e drejta e informimit për qytetarët, të cilëve u njihet e drejta të jenë të pranishëm në mbledhjet e organeve të zgjedhura.

Në ligjin nr. 8550, datë 18.11.1999 “Statusi i deputetit” janë përcaktuar detyrimet e deputetit në marrëdhëniet me zgjedhësit.

Në nenin 4, pika 3 thuhet: “Deputeti ka të drejtë të shprehë lirisht mendimet e tij dhe të zgjedhësve që ai përfaqëson, nëpërmjet diskutimeve, propozimeve, debatit, interpelancave dhe pyetjeve, mocioneve, deklaratave dhe votës.”

Në nenin 5 theksohet: “Deputeti merr takim periodikisht vetë me zgjedhësit ose kur e kërkojnë ata. Ai i përfaqëson ata duke marrë mendime për projektligje, amendamente, vendime dhe materiale të tjera që shqyrton Kuvendi, si dhe mund të marrë pjesë në zbërthimin dhe shpjegimin e tyre.”

Në nenin 10 nënvizohet: “Organet shtetërore janë të detyruara të marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat dhe propozimet e bëra nga zgjedhësit nëpërmjet deputetit dhe brenda një muaji, nga data e paraqitjes së tyre, detyrohen të njoftojnë deputetin për mënyrën e trajtimit të tyre.

II. KODI I SJELLJES (ETIKA) I DEPUTETIT.

1. Mandati i deputetit, mandat përgjegjësie.

- Zonat zgjedhore, bashkësitë me njerëz të ndryshëm dhe probleme të ndryshme.

- Përfaqësimi i popullit në organin më të lartë ligjvënës, përgjegjësi e madhe.

2. Komunikim i deputetit në fushatë zgjedhore dhe pas fushate.

- Sjellja e deputetit nuk duhet të ndryshojë me zgjedhësit pas marrjes së mandatit.

- Kontakte periodike me zgjedhësit, veçanërisht me vullnetarët e angazhuar në fushatë.

- Vizita të herëpashershme në vendet që frekuentoheshin më tepër nga deputeti gjatë fushatës.

- Shkëputja e kontaktit me zgjedhësit dhe vullnetarët lë shije të hidhur tek ata.

3. Takimet e lira me zgjedhësit.

- Qytetari është i painformuar dhe me probleme.

- Mos refuzo takimet me zgjedhësit në çdo lloj mjedisi, kur të kërkoet rastësisht një gjë e tillë.

- Mospranimi i ashpër, qoftë edhe me arsye, i kontaktit me zgjedhësit krijon imazh të keq për deputetin.

- Mos harro shpesh kërkesa për takime të rastit mund të jetë, thjesht, për të dhënë një urim ose përsëndetje.

4. Shoqëruesit e deputetit gjatë vizitës në zonën zgjedhore.

- Deputeti gjatë vizitave të punës në zonë duhet të shoqërohet nga njerëz me autoritet dhe mandat përfaqësimi dhe jo nga “të fortët” e zonës dhe bodigardët.
- Shoqërimi i deputetit me bodigardë është fyerje për zgjedhësit.

5. Njohja e problemeve kryesore të zonës.

- Nuk lejohet të thuhet: “Nuk e di këtë problem!”
- Për problemet kryesore të zonës deputeti duhet të formulojë përgjigje bindëse.

6. Respekt për zgjedhësin që kërkon takim me deputetin.

- Mirësjellje në takim.
- Deputeti nuk mund të thotë: “Kjo nuk është puna ime, nuk është kompetenca ime, shko ku të duash!”
- Deputeti duhet t’i shpjegojë qartë zgjedhësit se ku, kur, si dhe kush e zgjidh problemin e tij.
- Asnjëherë nuk mund të thuhet: “Do ta shikojmë problemin tënd” dhe të mos mbahet asnjë shënim që provon seriozitetin e deputetit ndaj problemit të zgjedhësit.
- Deputeti nuk merr përsipër gjëra që nuk bëhen.

7. Takime periodike me zgjedhësit.

- Në çdo rast respektohet dita dhe orari i takimit me zgjedhësit.
- Zgjedhësit duhet të njihen paraprakisht me vendin, ditën dhe orën kur deputeti pret në zyrë zgjedhësit.

8. Si komunikohet me qytetarët në zyrë.

- Gjithmonë i pranishëm një sekretar që mban shënime.
- Emri, problemi, adresa, telefoni.
- Përgjigje me shkrim ose me telefon për problemin në fjalë.
- Në tavolinë: Statusi i deputetit, programi zgjedhor.

9. Zyra e deputetit- zyrë solemne.

- Flamuri Kombëtar dhe portreti i Presidentit.
- Harta e zonës zgjedhore.
- Fletoret Zyrtare.
- Deputeti është i përqendruar, me pamje korrekte dhe asnjëherë nuk duhet t'i vijë era alkool.

10. Sekretaria telefonike e deputetit.

- Mirësjellje, gatishmëri për shërbim.
- Lista e telefonuesve të çdo dite i bëhet me dije deputetit.

11. Komunikimi periodik me zgjedhësit.

- Seancat parlamentare.
- Veprimtari të ndryshme në zonë.
- Kontakte fizike përmes kartëvizitës, letër informimi, urim për festa, komunikim me e-mail, telefon etj.

12. Unë jam me ju.

- Deputeti - i pranishëm kudo ku ka probleme në zonë.
- Ai duhet të jetë i pranishëm në festa, gëzime dhe në fatkeqësi të ndryshme.

13. Imazh pozitiv gjatë tërë mandatit.

- Respektimi i Statusit të deputetit.
- Të jesh vazhdimisht në anën e ligjit.
- Përfaqësim serioz i zonës zgjedhore në Kuvend.
- Etika e sjelljes me zgjedhësit.

Komunikimi me zgjedhësit dhe efektiviteti i veprimtarisë së deputetit

Z. Ferid Hoti
Deputet

Të qenurit deputet vazhdon të jetë jo vetëm përfaqësim, por edhe ushtrim përfaqësimi në bashkëpunim dhe në interes të Shtetit Shqiptar dhe të elektoratit, dhe ky kuptim po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm, por edhe më sfidues në arenën parlamentare në Shqipëri. Ushtrimi i përfaqësimit në bashkëpunim me elektoratin përbën një synim për mua si deputet në përmbushjen e rolit dhe përgjegjësi të mia, një synim i cili nuk mund të realizohet vetëm me përpjekje të njëanshme nga ana ime. Puna me elektoratin vazhdon të përbejë një detyrim të qartë, pasi “askush nuk mund të përfaqësojë vullnetin e popullit, nëse ky vullnet nuk i bëhet të ditur popullit”.

Klima politike e tensionuar, ku përfaqësuesit e opozitës vazhdojnë të shikohen dhe trajtohen nga shumica parlamentare si dekor politik dhe jo si pjesë jetësore e një procesi legjislativ dhe demokratik, ka prodhuar një demokraci të mangët, si dhe pengesa serioze në komunikimin tonë si deputetë të opozitës me një pjesë të elektoratit që përfaqësojmë, pasi ajo pjesë e elektoratit, që ka votuar për një program politik të ndryshëm nga ai që unë përfaqësoj, nuk ndihet e qetë dhe e lirë politikisht për realizimin e ndërgjegjshëm të një komunikimi konstruktiv me deputetin e zonës.

Politikë përparësore e imja në ushtrimin e rolit dhe të përgjegjësi si deputet vazhdon të jetë angazhimi efektiv i elektoratit në çështje me rëndësi zhvilluese dhe komunikimi me zgjedhësit, nëpërmjet mjeteve dhe metodave të ndryshme

që ofron gjendja dhe mundësitë aktuale. Qëllimi im është të mos mbetem një deputet i fushatës zgjedhore, por një deputet i cili të konsumojë mandatin zgjedhor në praninë dhe me bashkëpunimin e elektoratit.

Komunikimin me shkrim me elektoratin tim e kam filluar që në legjislaturën 1997-2001 dhe në fushatën e fundit zgjedhore nëpërmjet një gazete ku kam paraqitur programin tim për zonën zgjedhore nr.6, ku konkurroja; program, i cili bënte të njohura angazhimet e mia në fushën ekonomike, sociale dhe të zhvillimit fizik të zonës. Këtë program zgjedhor më pas e kam zhvilluar më tej në një alternativë ekonomike, të cilën ia komunikova elektoratit me një libër ku është shpjeguar dhe analizuar një alternativë të zhvillimit ekonomik të Shkodrës, siç është krijimi i zonës së lirë. Kjo është një nismë zhvilluese që i përshtatet pozicionit gjeografik dhe fizik të Bashkisë së Shkodrës dhe gjendjes së saj ekonomike, alternativë, e cila ka dhënë rezultat në ekonomi analoge, të cilat kanë diktuar nevojën për eksperimentim marrëdhëniesh të reja ekonomike në nivel vendor. Kjo alternativë ekonomike është zhvilluar në bashkëpunim me ekspertizën vendore, siç është ajo e Universitetit të Shkodrës, por edhe me ekspertizë ndërkombëtare. Për këtë alternativë sensibilizova elektoratin e zonës 6, por edhe elektoratin e Bashkisë së Shkodrës në përgjithësi, si dhe të gjithë autoritetet politikëbërëse në nivel vendor dhe qendror. Për realizimin e këtij synimi kam vënë në lëvizje edhe Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për plotësimin e mangësive themelore e lindjen e ligjit të ri nr.8636 të gushtit 2000 për zonat e lira ekonomike. Realizimi në Shkodër i zonës së lirë ekonomike vazhdon të jetë përparësia ime. Elektorati i qytetit u bashkua me këtë synim timin. 15 mijë banorë bënë një peticion në adresë të Kuvendit, për të përfituar këtë status.

Komunikimi i vazhdueshëm me zgjedhësit përbën një përparësi për mua si deputet dhe në funksion të kësaj u angazhova në hapjen e Zyrës Zgjedhore dhe emërimin e një sekretari me qëllim përmirësimin dhe lehtësimin e komunikimit institucional dhe të planifikuar (praktikuar për herë të parë në Shqipëri dhe më vonë ligjëruar nga Kuvendi).

Stafi i kësaj zyre, aktualisht sekretari, ka dhënë rezultat të dukshëm në ndihmën për prezantimin dhe dokumentimin e alternativës ekonomike “Zona e Lirë në Shkodër”. Funksionimi eficient i kësaj zyre do të ketë si përparësi vendosjen e një komunikimi më efektiv e më dokumentar, kryesisht me letra dhe nëpërmjet postës, veçanërisht për çështje, probleme, përparësi dhe ankesa të elektoratit. Sekretaria është trajnuar nga IRI në seminarin dyditor 14-15 dhjetor 2001 në fushën e lehtësimit të komunikimit të deputetit me elektoratin dhe median, organizimin e zyrës, planifikimin e takimeve etj. Mendoj se trajnimi i sekretarëve duhet të vazhdojë.

Zyra ka filluar të ofrojë shërbime, informacion të dyanshëm si për deputetin, ashtu edhe për elektoratin. Gjithsesi, komunikimi i deputetit me elektoratin vazhdon të dominohet nga metoda e komunikimit të drejtpërdrejtë, nëpërmjet takimeve spontane të përditshme dhe takimeve të organizuara.

Tashmë unë dhe sekretari e kemi të qartë rolin dhe funksionet e kësaj zyre, si dhe e kemi të qartë faktin se sekretari, në ushtrimin e funksioneve të tij në këtë zyrë, nuk përfaqëson thjesht deputetin, por Zyrën e Deputetit. Ndër objektivat e punës së sekretarit do të jetë realizimi periodik dhe i planifikuar i komunikimit me median dhe me organet ekzekutive dhe politikëbërëse, në nivel vendor dhe qendror, si dhe me elektoratin. Mendojmë të fillojmë punën për dokumentimin e çështjes që përbën rast dhe përgatitjen e dosjeve për secilin nga këto raste. Do të vazhdojmë punën për dokumentimin e politikave dhe alternativave zhvilluese.

Komunikimi periodik me elektoratin, me qëllim përfshirjen e elektoratit dhe tërheqjen e opinioneve dhe të mendimeve të tij në proceset e vendimmarrjes vendore dhe qendrore, e shoh si një element të bashkëpërgjegjësisë në kuadër të një kulture, ku deputeti është përfaqësues gjithpërfshirës dhe jo imponues interesash grupazhi dhe vetjake, duke kontribuar kështu në krijimin e një sistemi llogaridhënieje dhe kontrolli.

E shoh të nevojshme që si deputet të komunikoj me elektoratin me një gazetë periodike, ku të informohet elektorati për procesin legjislativ në Kuvend,

qëndrimet që mbaj në këtë proces, si dhe ndaj ligjeve të veçanta, çështje që përbëjnë përparësi për zonën zgjedhore dhe opsionet dhe opinionet që i kanë ardhur Zyrës Zgjedhore për këto çështje. Kjo gazetë do të lehtësojë praninë e kërkesave dhe mendimet e mia dhe të elektoratit që përfaqësoj në përmirësimin e punës së ekzekutivit vendor. Kjo gazetë mendoj të përmbajë edhe çështje që fokusohen në shpjegimin e efekteve që kanë ligjet ose marrëveshjet ndërkombëtare në ekonominë dhe mirëqenien e elektoratit të zonës.

Komunikimin periodik me elektoratin nëpërmjet medias vendore vazhdoj ta konsideroj të domosdoshëm dhe frytdhënës dhe për këtë do të përgatis një program.

I kemi të pakta burimet financiare për të përballuar realizimin e funksioneve të Zyrës Zgjedhore, pasi shpenzimet operative për përballimin e intensitetit të komunikimeve dhe organizimeve të mbledhjeve me elektoratin llogariten të jenë të mëdha.

Në rolin tim si deputet, për të përfaqësuar vullnetin politik dhe programor të zonës, kam lehtësuar krijimin e kontakteve dhe të nismave për zhvillimin e politikave të bashkëpunimit ekonomik dhe shkëmbim të mallrave dhe njerëzve me vendet fqinje, si Mali i Zi dhe Italia, si dhe me Kosovën.

Përparësi afatshkurtër e imja do të jetë kërkesa, në bashkëpunim me qeverinë vendore, pranë Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, për lëvrimin e fondeve dhe realizimin në afat të rrugës së re Lezhë-Shkodër, si një ndër investimet publike me rëndësi jetike për Bashkinë e Shkodrës dhe të zonës përreth saj. Zyra Zgjedhore do të luajë rolin e saj edhe për këtë përparësi, sidomos në bashkërendimin e vullnetit dhe presionin nga ana e deputetëve të zonave që ndikohen nga ndërtimi dhe rehabilitimi i kësaj rruge dhe i hekurudhës Shkodër-Podgoricë, 14 km, së cilës i mungojnë shinat. Personalisht mendoj se ka shumë për të bërë në përmirësimin e komunikimit të deputetit me elektoratin e sidomos në organizimin, planifikimin dhe institucionalizimin e kontakteve dhe sigurimin e informacionit të vazhdueshëm. Deputeti duhet të jetë më i pranishëm

në linjat e komunikimit me elektoratin dhe organizmat politikëbërëse me efekt në zonat zgjedhore që përfaqësojmë.

Edhe ne si deputetë kemi nevojë për trajnim përse i përket metodave dhe teknikave të komunikimit efektiv me elektoratin, organet e qeverisjes vendore dhe organizmat e tjera vendase dhe ato ndërkombëtare, si në rastin e procesit të miratimit të ligjeve dhe të buxhetit. Duke u përpjekur të kapërcejmë pengesat e ekzekutivit qendror, ne duhet të vazhdojmë të përpiqemi të përfshihemi më aktivisht në procesin e buxhetimit që në fazat e tij më të hershme, siç është komisioni parlamentar përkatës, duke pasur parasysh edhe përparësitë e zonave zgjedhore që përfaqësojmë.

Pjesëmarrja e publikut në procesin legjislativ: Transparenca në veprimtarinë e Kuvendit

*Z. Njazi Jaho
Jurist*

Pjesëmarrja e publikut ose e shoqërisë civile në procesin legjislativ është e lidhur ngushtë me transparencën parlamentare.

Kohët e fundit po bëhen më të shpeshta deklaratat për nevojën e një pjesëmarrjeje më aktive të shoqërisë civile në jetën e vendit në tërësi dhe në procesin legjislativ, në veçanti.

Është pozitive që deklaratat të tilla kanë filluar të konkretizohen në praktikë. Në të njëjtën kohë bien në sy edhe qëndrime të shoqëruara me elemente të formalizmit dhe të spontaneitetit konjunktural. Në këtë drejtim ndikon negativisht politizimi i tejskajshëm i problemeve që preokupojnë vendin. Kuvendi, siç dihet, miraton ligjet. Nisma ligjore, sipas Kushtetutës, mund të ndërmerret nga Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës. Këshilli i Ministrave është subjekti kryesor që harton projekte dhe ia dërgon Kuvendit për miratim, madje asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit ose që pakëson të ardhurat, nuk mund të hartohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave. Në këtë tablo procedurale, kam mendimin se ndikimi i shoqërisë civile, që pjesërisht përfaqësohet nga organizatat joqeveritare, nuk ndihet sa duhet, ndërsa ai i publikut në tërësi është tepër i zbehtë.

Kjo mendojmë se ndodh për shkak të mungesës së një vizioni të qartë mbi

rolin e shoqërisë civile në procesin legjislativ. Si rrjedhim, mungon edhe metodologjia përkatëse e angazhimit të forcave më të gjalla të kësaj shoqërie në këtë proces kaq të rëndësishëm dhe të brishtë.

Cili do të ishte çasti më oportun, më i përshtatshëm, më rezultativ i kësaj pjesëmarrjeje? Mendimet mund të ishin nga më të ndryshmet. Kur ato shoqërohen me argumente, edhe pse mund të ketë kundërshti, duhen vlerësuar. Receta nuk mund të jepen. Megjithatë, elemente të përbashkëta mund të gjenden dhe të diskutohen. Ka raste kur nëpërmjet televizionit ose shtypit të përditshëm informohemi se ky ose ai projektligj i kaloi Kuvendit, se një grup deputetësh kanë përgatitur një projektligj etj. Ka edhe raste të tjera kur për herën e parë informohemi se sot ose nesër Kuvendi shqyrton dhe miraton këtë ose atë projektligj.

Nuk mund të pretendohet që çdo projektligj të diskutohet me publikun ose me shtresa të ndryshme të popullit. Do të ishte gabim të mendohej se për çdo projektligj organizatat joqeveritare duhet të shprehnin mendimin e tyre. Por ka projekte që pjesëmarrja e shoqërisë civile është e nevojshme. Në radhë të parë mund të renditeshin ato projekte që në formë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë kanë të bëjnë me parimet kushtetuese, me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe me probleme të tjera që i dikton praktika dhe që preokupojnë njerëzit. Në këtë grup mund të përfshihet edhe legjislacioni që ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit etj.

Si dhe kush duhet ta përcaktojë këtë? Deputetët, të organizuar në komisione parlamentare, me transparencë janë në gjendje të përcaktojnë nëse do të ishte e nevojshme pjesëmarrja për të cilën bëhet fjalë, pse jo, nisma të tilla mund të merreshin edhe nga vetë OJQ-të. Në fakt, ka disa shembuj pozitiv. I efektshëm ka qenë p.sh., ky bashkëpunim midis tri komisioneve parlamentare: të ligjeve, të rendit dhe SHISH-it dhe të Drejtave të Njeriut me Qendrën Shqiptare të të Drejtave të Njeriut.

OJQ-të mund të ndërmerrnin edhe me tepër nisma të tilla, në qoftë se projektligje të rëndësishme do të publikoheshin paraprakisht në shtyp, do të

jepeshin informacione ose do të organizoheshin emisione radiotelevizive etj. Botimi në shtyp i projektligjeve për komisionet hetimore parlamentare ishte, në fakt, nxitje për organizimin e tryezës së rrumbullakët të datës 12 shkurt të këtij viti. Mjaft e dobishme dhe rezultative ishte dhe nisma e Komisionit të Përhershëm të Ligjeve për diskutimin e projektligjit mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave.

Kam bindjen se deputetët e pozitës dhe opozitës në këtë takim patën rastin të vërejnë se mendimet e argumentuara dhe objektive të ekspertëve ndihmuan në pozicionimin më të drejtë të vetë deputetëve.

Kjo tregon transparencë dhe vlerësim për specialistët dhe shoqërinë civile, pavarësisht se në ndonjë rast të shkëputur ka stonuar ndërhyrja pa takt dhe mospërfillëse e ndonjë deputeti që, edhe në raste të tilla, mendon se është në sallën e Kuvendit dhe ka përpara kundërshtarë politikë.

Jo, përvoja ka vërtetuar se ekspertë që nuk kanë ndikime partiake, si dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, kur prononcohen, flasin ose luajnë, nuk llogarisin dhe as mbajnë shënime se kush do t'i mbështesë dhe kush do të jetë dakord me ta, ndryshe diskutimi dhe debati konstruktiv do të frenohej ose do të nxirrnin kokë elemente të servilizmit dhe konformizmit, prej të cilave ne kemi vuajtur shumë në të kaluarën.

Ndihmesa modeste e disa organizatave joqeveritare, siç është për shembull, ai i Qendrës Shqiptare të Drejtave të Njeriut, i Komitetit Shqiptar të Helsinkit etj., në diskutimin e disa projektligjeve është nxitës. Mund të përmendim këtu disa projektligje që është dashur të ripunohen, madje edhe t'u rikthehen qeverive, siç janë projektligjet për SHIK-un, statusin e nëpunësit civil, policinë e shtetit, për tubimet, OJQ-të etj. Në hartimin dhe diskutimin e projektligjeve ka dhënë ndihmesë, gjithashtu, edhe Instituti i Studimeve Bashkëkohore, si dhe Qendra Studimore Parlamentare që është edhe organizatorja e këtij takimi.

Procesi i hartimit të projektligjeve, siç u tha më lart, shpesh fillon jashtë Kuvendit. Por, shumë rrallë, (me përjashtim të Ministrisë së Rendit dhe pjesërisht

të Ministrisë së Drejtësisë) ekzekutivi praktikon diskutimin paraprak të projektligjeve që ai përgatit. Informacioni në këtë drejtim është i dobët, ndërsa nevoja për ndihmesën që mund të jepte shoqëria civile, kam përshtypjen se ndjehet pak. Duket se ky problem konceptohet ngushtë.

Ka mendime, madje edhe në rrethe juristësh, se pjesëmarrja e shoqërisë civile në ndryshimet ligjore ose hartimin e disa projektligjeve që kanë karakter profesional, siç janë p.sh. ndryshimet në Kodin Penal ose Kodin e Procedurës Penale, nuk është e nevojshme me “arsyetimin” se s’ka çfarë të japin etj. Në fakt, publiku, shoqëria civile dhe disa organizata joqeveritare të angazhuara në fushën e mbrojtjes, të lirive dhe të drejtave të shtetasve janë të interesuara për problemet e kriminalitetit dhe respektimin e të drejtave të ndaluarve, të të paraburgosurve dhe të dënuarve, pra, si rrjedhim, edhe ato mund të ndihmojnë në përmirësimin e këtij legjislacioni.

Të gjithëve na kujtohet se kur u shtrua çështja e hartimit të Kodit Zgjedhor, debati politik ishte i ashpër dhe i tensionuar. Kam mendimin se pikërisht për këtë arsye u anashkalua ose u nënvleftësua debati juridik në një rreth më të gjerë specialistësh. Vetë Kodi u përgatit me nxitim, çka pengoi refleksione më të thella. Debatet televizive për këtë Kod nga të dy anët ishte me ngjyrimë politike. Është për të ardhur keq se edhe ndonjë ekspert partiak nuk i shpëtoi këtij ndikimi.

Ne kemi dhe do të kemi edhe në të ardhmen shumë nevojë, që në hartimin e disa projektligjeve të rëndësishme të kërkojmë asistencën e huaj, por ky fakt nuk mund të justifikojë mosangazhimin në këtë fushë të specialistëve tanë, që nuk janë të paktë në numër dhe që kanë si aftësitë, ashtu edhe përvojën.

U zgjata pak në këtë çështje, sepse problemi i përmirësimit të legjislacionit zgjedhor është në rend të ditës. Ai është aktual, i mprehtë dhe i rëndësishëm. Në këtë drejtim preokupacioni i forcave politike është plotësisht i justifikueshëm. Do të dëshironim që ky proces të zhvillohej normalisht dhe pa eksese. Në këtë vështrim, më lejoni të parashtoj sugjerimet e mëposhtme. Së pari, nuk duhen as të vonohemi, por as të nxitohemi, sepse në të dy rastet pasojat mund

të ishin të dëmshme. Së dyti, kam mendimin se në diskutimin dhe debatin e këtij problemi përparësi duhet të kenë argumenti dhe kundërargumenti dhe jo pasioni partiak dhe politizimi i tejskajshëm. Këto dy elementet e fundit mund t'i neutralizojë logjika e shëndoshë dhe objektive juridike, në qoftë se ajo vlerësohet nga deputeti dhe i gjithë spektri politik në Kuvend. Së treti, media e shkruar dhe ajo elektronike, krahas debatit partiak dhe intervistave të drejtuesve partiakë, të krijojnë vend dhe hapësirë edhe për mendimin e mirëfilltë dhe të specializuar intelektual dhe, së fundi, të evidentohen defektet e dispozitave përkatëse të Kodit Zgjedhor që vërtetoi praktika. Në këtë drejtim mund të jepnin ndihmesë anëtarë të komisioneve të zgjedhjeve, gjyqtarë, përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore, si dhe organizatat joqeveritare të angazhuara në vëzhgimin e zgjedhjeve.

Sensibilizimi i opinionit publik para dhe pas miratimit të ligjeve është i një rëndësie të veçantë. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim mund të luajnë organizatat joqeveritare. Është për të ardhur keq, por është edhe fakt, se ka sektorë ose degë të administratës shtetërore që nuk njohin mirë dhe në detaje as ato ligje dhe akte nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre, pa folur pastaj për grupe të caktuara të popullatës. Mosvlerësimi që vërehet lidhur me këtë çështje të bën të kujtosh dhe të përmendësh Abraham Linkolnin, që para 140 vjetëve thoshte: "Nderimin për ligjin çdo nënë amerikane le t'ia mësojë fëmijës që bëlbëzon në gjirin e saj, le të mësohet në shkollë, në seminare dhe në kolegje, le të praktikohet në katedra, le të shpallet në sallat e ligjvënësve dhe le të detyrohet nga gjykata."

Shoqëria civile dhe ligji: një marrëdhënie në zhvillim

Gent Ibrahimi
Drejtor Ekzekutiv
Instituti për Studime Publike Ligjore

SFONDI HISTORIK

Raporti i shoqërisë civile me ligjbërjen është një koncept në radhë të parë politik. Intensiteti i këtij raporti ose, në të kundërtën, mefshtësia e tij, përbën një indikator të rëndësishëm të nivelit të demokracisë politike dhe të shtetit të drejtës në një sistem të caktuar. Në fillimet e organizimit të shoqërisë njerëzore, shoqëritë e para demokratike (demokracia vetëm për meshkujt e lirë) e kanë pasur relativisht të lehtë të kuptojnë raportin midis ligjbërjes dhe shoqërisë. Kështu, për grekët dhe romakët ligji dhe shoqëria ishin dy anë të së njëjtës medalje. Midis tyre kishte një *continuum* të pandërprerë. Me fjalë të tjera shoqëria ishte njëkohësisht subjekt dhe objekt i rregullave, pavarësisht nga teoritë e shumta që lulëzuan në atë kohë në lidhje me burimin e së drejtës.

Në epokën e feudalizmit, me zgjerimin e bazës sociale të njësive shtetërore, që i dedikoheshin zhdukjes të skllavërisë, raporti i shoqërisë me ligjin u komplikua paksa, por sidoqoftë ishte ende relativisht e lehtë të dalloje lidhjen midis përmbajtjes së normës juridike dhe interesave të grupeve zotëruese në shoqëritë e asaj kohe. Kështu, kjo periudhë korrespondon me krijimin e *gildeve (esnafëve)* të cilat, si forma elementare të organizimit sindikal, luajtën një rol shumë të rëndësishëm në procesin e ligjbërjes, duke imponuar idetë dhe interesat e tyre.

Në mënyrë paradoksale, raporti i shoqërisë me ligjbërjen, si një koncept i teorisë së të drejtës, erdhi duke u komplikuar me konsolidimin e shteteve

kombëtare në fund të shekullit të 18-të dhe sidomos gjatë shekullit të 19-të. Në këtë periudhë gjithnjë e më shumë ligjbërja u bë një çështje e burokracisë. Gradualisht, kancelaritë përforcuan monopolin mbi ligjbërjen deri në atë pikë sa që koncepti se ligji buron domosdoshmërisht nga një shtet sovran u ngulit thellë në doktrinat juridike të të gjitha vendeve. Shoqërisë i mbeti konventa, sipas së cilës ligji vërtet bëhet nga shteti, por ky i fundit ama kushtëzohet nga interesat dhe axhendat e shoqërisë civile. Pra, me një fjalë të vetme, pozitivizmi¹⁾ absolut i kësaj periudhe i ngushtoi deri në minimum hapësirat e shoqërisë, për të ndikuar efektivisht në bërjen e rregullave. Duke pranuar se po bie në një nivel relativisht të lartë abstraksioni, do të thosha gjithsesi se edhe vetë luftërat botërore, të cilat përkojnë me krijimin dhe konsolidimin e shteteve kombëtare, janë në një farë mase tregues i shkëputjes dramatike midis interesave të shoqërisë, ashtu siç i koncepton ajo dhe axhendave zyrtare të kancelarive të asaj kohe.

Duke filluar që nga gjysma e parë e shekullit të 20-të, demokratizimi i jetës politike në shoqërinë perëndimore kushtëzoi ridaljen në skenë të raportit të shoqërisë me ligjin, pas një periudhe të gjatë të mbretërimit të pozitivizmit absolut, jo vetëm në praktikën e bërjes së ligjeve, por dhe në teorinë e së drejtës. Shumë shkollarë të së drejtës filluan të argumentojnë, gjithnjë e më me guxim, se shoqëria luan rol në bërjen e ligjeve, pavarësisht se burimi zyrtar i ligjit, mbetet shteti. Kësaj periudhe i takon edhe koncepti i *legjitimitetit të ligjit*, që do të thotë se ligji nuk ka kuptim për sa kohë që nuk është legjitimuar, pranuar nga shoqëria. Me fjalë të tjera, ligji, pavarësisht se miratohet formalisht nga strukturat shtetërore, ai duhet të jetë një koncentrat i të dhënave empirike që rezultojnë në praktikë nga jeta e shoqërisë. Kështu p.sh., një ligj që rreket të rregullojë transaksionet tregtare midis privatëve, duhet patjetër të reflektojë realitetin dhe problematikën e këtyre marrëdhënieve, në mënyrë që të jetë i përdorshëm dhe i pranueshëm nga shoqëria. Ishin pikërisht këto zhvillime në

¹⁾ *Vendosja e rregullave nga shteti, në dallim nga common law, si përmbledhje e rregullave të vendosura nga vetë shoqëria.*

teorinë e të drejtës, që krijuan shtratin për rivitalizimin e konceptit demokratik të rolit politik të shoqërisë (në formën e ligjbërjes) në gjysmën e parë të shekullit të 20-të.

Infrastruktura për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në bërjen e ligjeve

Sa më sipër, mund të konsiderohet si një historik i shkurtër i procesit që bëri politikisht të mundur rolin e shoqërisë civile në bërjen e rregullave me zbatim të përgjithshëm. Natyrisht që arritja politike në vetvehte nuk mund të bëjë të mundur realizimin praktik të rolit të shoqërisë në bërjen e ligjeve. Që kjo të ndodhë, duhet zhvilluar ajo që unë e kam quajtur infrastrukturë për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në bërjen e ligjeve. Në fakt, pjesëmarrja në bërjen e ligjeve është elitare. Ajo presupozon në radhë të parë pjesëmarrjen në jetën politike, në kuptimin më të gjerë të mundshëm, nëpërmjet procedurave të demokracisë së drejtpërdrejtë, si referendumi, dhe asaj përfaqësuese, nëpërmjet zgjedhjeve. Në këtë pikë mund të shtrohet një pyetje: Ç'është nevoja të kërkohen mekanizma për përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e ligjbërjes, përderisa demokracia përfaqësuese funksionon? Me fjalë të tjera, a nuk mjafton zgjedhja e disa bashkëqytetarëve në institucionet përfaqësuese, që shoqëria të sigurohet se përmbajtja e normave juridike do të jetë në përputhje me interesat e saj? Pa dashur të zhvlehtësoj potencialin e demokracisë përfaqësuese si sistem, do të thosha, gjithsesi, se përfaqësimi i shoqërisë në institucionet demokratike mbetet në një masë të madhe fikSION.

Dy janë faktorët që e bëjnë demokracinë përfaqësuese t'i ngjajë më shumë një fikSIONI kushtetues, sesa një sistemi real:

Partitokracia, duke qënë e domosdoshme për organizimin e jetës politike në një vend të caktuar, përbën sidoqoftë një ndër rreziqet më të mëdha, që shkakton deformimin e skemës së përfaqësimit. Partitë shndërrohen në një filtër të interesave të grupeve të ndryshme shoqërore dhe hallkë midis shoqërisë dhe institucioneve përfaqësuese. Sidomos në demokracitë e reja të Lindjes, ku partitë shpesh identifikohen me luftën kundër totalitarizmit, ato kanë prirjen t'i ngjasojnë më shumë fronteve politike, sesa një force që përfaqëson një pjesë të

spektrit social. Super roli i partive në një sistem, zakonisht përkon me një shoqëri civile të zbehtë dhe të paaftë për të diktuar axhendat zyrtare. Jo vetëm shoqëria civile, por edhe institucionet shtetërore kanë prirjen të zhvleftësohen nga roli i ekzagjeruar i partive politike në një vend. Partitokracia, në rastet kur shndërrohet në një patologji akute, është në gjendje të izolojë plotësisht shoqërinë nga institucionet përfaqësuese.

Burokracia. Me rritjen e rolit rregullator të shtetit në shoqëri, aq më tepër në skenarin e shtetit patenalist, lind domosdoshmëria e krijimit të një klase të gjerë burokratësh të cilët mbyllin ciklin e përfaqësimit në një demokraci kushtetuese. Potenciali i burokracisë për deformimin e përfaqësimit është më i vogël se ai i partive dhe për më tepër është negativ. Dua të them se ndërsa partitë janë aktivisht të përfshira në bërjen e politikave dhe, për pasojë, nëpërmjet veprimit pozitiv mund të deformojnë procesin e përkthimit të interesave të shoqërisë, burokracia mundet ta bëjë një gjë të tillë kryesisht nëpërmjet mosveprimit. Megjithatë, edhe burokracia, duke u motivuar nga interesa korruptive ose thjesht nga paaftësia, mundet të kompromentojë aftësinë e sistemit për të prodhuar një qeverisje që i përgjigjet interesave të publikut.

Sa më sipër, nuk janë pikëpamjet e një anarkisti që përpiqet të argumentojë në favor të instalimit të një demokracie klasike të tipit të Athinës së lashtë, ku të gjithë qytetarët janë idealisht aktivë në jetën politike. Përkundrazi, personalisht jam i mendimit që demokracia e drejtpërdrejtë në ditët tona, në qoftë se nuk kanalizohet drejt, ka më shumë të ngjarë të shpjerë drejt autoritarizmit (nëpërmjet populizmit), sesa mosfunksionimit perfekt të demokracisë përfaqësuese. Qëllimi i këtyre paragrafëve është të tregojnë se në ditët tona mekanizmat e përfaqësimit nuk janë kursesi të mjaftueshme për të mundësuar një rol aktiv të shoqërisë civile në procesin e bërjes së politikave dhe ligjeve.

Po cilat janë, pra, rrugët për të maksimalizuar impaktin e shoqërisë civile mbi ligjbërjen?

Unë do t'i ndaja në dy grupe të mëdha. Në grupin e parë futen ata faktorë

dhe procese që kanë të bëjnë me vetë shoqërinë civile. Në grupin e dytë futen proceset e përsosjes së vazhdueshme të bazës ligjore dhe të jetës politike.

